

1 E mërkurë, 17 nëntor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 12.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
6 paraqisni çështjen.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
8 Gjykatës -- mirëdita më saktë, kjo është çështja KSC-BC-2020-
9 06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri
10 Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal, vërej se të katër të akuzuarit janë të pranishëm
13 në sallën e gjyqit.

14 Do të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes së
15 Thaçit, 1DW-007. Përpara se të fillojmë me dëshminë, ka disa
16 aspekte paraprake që dëshirojmë të trajtojmë.

17 Si fillim do të nxjerrim urdhrin me gojë si në vijim.

18 Urdhri i parë me gojë.

19 Trupi Gjykses vëren dhe mban parasysh kërkesën e
20 Mbrojtjes së Thaçit nga 13 nëntori 2025 për të mos
21 riklasifikuar dokumentin F03410 si dokument publik.

22 Trupi Gjykses vëren se në dokumentin 03452, ka udhëzuar
23 Zyrën Administrative që, ndër të tjera, ta riklasifikonte
24 dokumentin në fjalë brenda një jave nga dëshmia e Dëshmitarit
25 009. Duke mbajtur parasysh se dokumenti F03410 përmban

1 informacione identifikuese për një dëshmitar që është
2 tërhequr, dhe ka identitet konfidencial, atëherë Trupi Gjykses
3 miraton kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit.

4 Rrjedhimisht, ndryshojmë urdhrin në paragrafin 91, 92, të
5 dokumentit F03452 dhe urdhëron Zyrën Administrative të mos e
6 riklasifikojë dokumentin F03410 dhe udhëzon Mbrojtjen e Thaçit
7 të dorëzojë versionin e redaktuar publik të dokumentit në
8 fjalë brenda të enjtes, 20 nëntor 2025.

9 Me kaq mbyll urdhrin e parë me gojë.

10 Më tej, vërejmë se më 17 nëntor 2025, Mbrojtja e Thaçit
11 dorëzoi një kërkesë urgjente për të ndryshuar listën e provave
12 materiale, përkatësisht në dokumentin F03580. Mbrojtja e
13 Thaçit bëri me dije se ZPS-ja nuk e kundërshton kërkesën në
14 fjalë.

15 ZPS-ja mund ta konfirmojë këtë gjë?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po, e konfirmojmë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtime nga ekipet e tjera të Mbrojtjes? Jo, nuk shohim
19 të ketë kundërshtime.

20 Në rregull, pasi morëm parashtimet e palëve, Trupi
21 Gjykses miraton kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit përkatësisht me
22 numër F03580 dhe urdhëron të dorëzojë listën e ndryshuar të
23 provave materiale brenda të premtës 21 nëntor 2025.

24 Me kaq mbyll urdhrin e dytë me gojë.

25 Tani, sa i takon programit të ditës së sotme, do bëjmë

1 një pushim dreke në 13.30, dhe do rikthehemi në orën 14.30,
2 dhe do të vazhdojmë deri në orën 16.30, si zakonisht, por do
3 të bëjmë një pushim prej dhjetë minutash në orën 15.30.

4 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
5 Mbrojtjes, 1DW-007.

6 Ju lutem, sillni dëshmitarin. Apo keni diçka?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Fillimisht, a mund të na lejoni të
8 shtojmë dokumentin që na lejuat në listën e provave materiale?
9 Bëhet fjalë për dokumentin që mbaron me 003. Duhet ta çojmë në
10 listën tonë të materialeve.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
12 kundërshtime?

13 Z. HALLING: [Përkthim] S'kemi asnjë kundërshtim.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E miratojmë
15 kërkesën.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Doni të punojmë deri në orën
17 13.30, apo do bëjmë një pushim të shkurtër?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne duam të
19 punojmë deri në orën 13.30, por në qoftë se dikush ka nevojë
20 për pushim, apo dëshmitari, sigurisht më bëni me dije dhe
21 bëjmë organizimin.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 [Përkthim] Më falni. Mos e sillni ju lutem dëshmitarin se
25 kam dhe diçka për të hënë që harrova ta thoja.

1 Së pari, dua t'ju rikujtoj se në dokumentin F03558, Trupi
2 Gjykues autorizoi që të merreshin masat vijuese sipas
3 rregullës 107 për këtë dëshmitar. Dëshmia e dëshmitarit do të
4 jetë vetëm për disa tema të caktuara, dhe fushëveprimi i
5 kundërpyetjeve duhet të jetë vetëm në përputhje me pyetjet që
6 ka bërë pala thirrëse dhe me aspekte që lidhen me
7 besueshmërinë. Dëshmitari mund të refuzojë t'u përgjigjet
8 pyetjeve për shkak të konfidencialit. Përfaqësuesit e
9 informacionit sipas Rregullës 107 janë të autorizuar të jenë
10 të pranishëm gjatë dëshmisë së Dëshmitarit 007 dhe dëshmitari
11 nuk është i autorizuar të japë dëshmi qoftë drejtpërdrejt apo
12 gjatë kundërpyetjeve për çështje që nuk janë të lejuara.

13 Trupi Gjykues nuk do t'i trajtojë pyetjet që nuk janë të
14 qarta dhe që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me informacionin
15 sipas rregullës 107, dhe që të jenë relevante për këtë lëndë
16 gjyqësore. Nëse ka paqartësi për këtë pikë, pala thirrëse
17 duhet të na argumentojë si lidhen pyetjet përkatëse me
18 fushëveprimin e rregullës 107.

19 Tani mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

20 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
22 Gjeneral. Ju lutem, qëndroni në këmbë.

23 Mirëdita Gjenerali Clark. Ju lutem, çohuni në këmbë vetëm
24 për një çast. Mirëdita.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëdita.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
2 çohuni për një çast në këmbë.

3 Sekretari i seancës do t'ju japë një tekst që është
4 betimi solemn të cilin duhet ta lexoni në përputhje me
5 rregulloren e Gjykatës. Ju lutem, lexoni me zë të lartë
6 dokumentin që keni në duar.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
8 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
9 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
10 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të
11 cilën kam dijeni.

12 DËSHMITARI: WESLEY CLARK

13 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 tani mund të uleni.

16 Sa i takon pjesëmarrjes, besoj se e keni vënë re të
17 gjithë që kemi përfaqësues të Shteteve të Bashkuara të
18 Amerikës. Ju lutem prezantohuni.

19 ZNJ. GEARHART-SERNA [Përkthim] Unë jam -- quhem Terra
20 Gearhart-Serna, jam juriste pranë Ambasadës Amerikane.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
22 që erdhët.

23 Gjenerali Clark, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
24 mendohet se do të zgjasë dy ditë. Sikurse mund ta dini,
25 fillimisht pyetjet do t'jua bëjë Mbrojtja e Thaçit, dhe më pas

1 ekipet e tjera të Mbrojtjes. Gjykatësit po ashtu mund të kenë
2 pyetje për ju, por sigurisht që do të ketë edhe ZPS-ja pyetjet
3 e veta.

4 Mbrojtja e Thaçit ka parashikuar se i nevojiten tre orë
5 për t'ju bërë pyetje. Ekipet e tjera së bashku kanë kërkuar
6 rreth një orë e 45 minuta. ZPS-ja mendon se i nevojiten katër
7 orë për t'ju bërë pyetje. Inkurajoj palët të jenë të
8 kujdesshëm në shfrytëzimin e kohës gjatë pyetjeve të tyre.
9 Trupi Gjykues mund të lejojë pyetje plotësuese nga të gjitha
10 ekipet nëse përmbushen kriteret përkatëse.

11 Ju lutem, Dëshmitar, përgjigjuni qartë me fjali të
12 shkurtra. Nëse nuk kuptoni një pyetje kërkon që pyetja të
13 përsëritet dhe, prapë nëse nuk e kuptoni, kërkon që pyetja të
14 sqarohet. Gjithashtu, na thoni bazën e njohurisë suaj për
15 faktet dhe rrethanat për të cilat do t'ju bëjmë pyetje.

16 Gjithashtu, ju lutem, flisni pranë mikrofonit dhe prisni
17 pesë sekonda përpara se t'u përgjigjeni pyetjes. Ju lutem, dhe
18 flisni me ngadalë për përkthyesit. Po përktheheni në shqip dhe
19 serbisht, prandaj duhet të keni parasysh që kjo është shumë e
20 rëndësishme. Gjatë kohës që jepni dëshmi në sallën e gjyqit,
21 nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
22 jashtë Gjykatës. Nëse dikush jashtë Gjykatës ju bën pyetje për
23 dëshminë tuaj, ju lutem na vini menjëherë në dijeni.

24 Ju lutem, ndërprisni fjalën nëse jua kërkoj unë.
25 Gjithashtu, ndërprisni fjalën nëse e shihni që unë ngre dorën,

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 7

1 sepse kjo do të thotë që unë duhet t'ju jap një udhëzim.

2 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, apo doni të
3 përsërisim diçka, ju lutem na thoni që të bëjmë organizimin
4 përkates.

5 Gjithashtu, kini parasysh që jeni i shoqëruar nga znj.
6 Gearhart-Serna, që është përfaqësuese e qeverisë së Shteteve
7 të Bashkuara të Amerikës. Ne kemi marrë një vendim në këtë
8 drejtim se dëshmia juaj do të ketë fushëveprim të kufizuar dhe
9 përfaqësuesja është pikërisht këtu të na ndihmojë për këtë.
10 Nëse ju keni dyshime për dëshminë tuaj, ju lutem kërkonj leje
11 nga Trupi Gjykses ose kërkonj këshilla nga përfaqësuesja e
12 Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

13 Të fillojmë tani me pyetjet nga z. Misetic, që përfaqëson
14 z. Thaçi. Ju lutem, dëgjojeni me vëmendje.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

16 Pyetje nga z. Misetic:

17 Z. MISETIC: [Përkthim]

18 PY. Mirëdita, Gjenerali Clark. Ne jemi takuar më përpara, por
19 për procesverbal unë quhem Luka Misetic.

20 PË. Nuk e kam të qartë zërin. Nuk e kam të qartë zërin. Mund
21 ta dëgjoja Gjykatësin, por ju nuk ju dëgjoj fare. Nuk më vjen
22 zë në dëgjuese.

23 PY. Po tani më dëgjoni?

24 PË. Diçka më mirë.

25 PY. Në çdo moment që keni probleme teknike, ngrini dorën në

1 mënyrë që ta zgjidhim menjëherë.

2 PË. Je larg nga mikrofoni, nuk ju dëgjoj mirë. Nuk ju dëgjoj
3 mirë.

4 PY. Po kështu, më dëgjoni më mirë?

5 PË. Mirë, përpigemi një herë.

6 PY. Në rregull.

7 PË. Nuk jam komod me --

8 PY. Është i lartë zëri?

9 PË. Jo, është shumë i ulët.

10 PY. Do përpigem kështu dhe në qoftë se keni vështirësi, ne do
11 të ndalojmë dhe do ta zgjidhim problemin teknik, në rregull?

12 PË. Po.

13 PY. Ju lutem, emrin dhe mbiemrin.

14 PË. Wesley K. Clark.

15 PY. Datëlindja?

16 PË. 23 dhjetor 1944.

17 PY. Shtetësia juaj?

18 PË. Shtetet e Bashkuara.

19 PY. A ju kujtohet që i keni dhënë deklaratë Mbrojtjes së
20 Thaçit që e nënshkruat më 20 tetor 2025?

21 PË. Po.

22 I lutem Sekretarit të Seancës të vendosë në ekran
23 materialin DHT12546 deri në DHT12556.

24 PY. Gjenerali Clark, e njihni dokumentin në ekran?

25 PË. Thuaje edhe një herë, ju lutem.

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 9

1 PY. E njihni dokumentin në ekran?

2 PË. Po.

3 PY. Çfarë është?

4 PË. Është deklarata ime.

5 PY. A është ky procesverbali i deklaratës që keni dhënë për
6 Mbrojtjen e Thaçit?

7 PË. Po, duhet të jetë si rregull, shoh vetëm faqen e parë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Seancës të
9 vijojë më tej në mënyrë që të shohim faqen që përfundon me
10 556.

11 PY. Gjeneral, a është nënshkrimi juaj?

12 PË. Po.

13 PY. A keni pasur shans ta shikoni dokumentin para se të vinit
14 sot në sallën e gjyqit?

15 PË. Po.

16 PY. A keni pasur shans tjetër ta shikoni këtë dokument javën
17 e shkuar?

18 PË. Po.

19 PY. A keni pasur mundësi të takoheshit me mua dhe kolegët e
20 mi javën e shkuar përmes videolidhjes?

21 PË. Po.

22 PY. Në atë videolidhje, a të dhanë mundësinë që të bëje
23 korrigjime dhe sqarime në këtë deklaratë?

24 PË. Po.

25 PY. A ju kujtohet që sqarimet dhe korrigjimet përkatëse i

1 hodhëm në një shënim, dhe këtë shënimin ta lexuam sërish?

2 PË. Po, më kujtohet.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Seancës të
4 vendosë në ekran materialin DHT12595 deri në DHT12596. Shohim
5 dokumentin shpejt në mënyrë që ta shohë dhe Gjenerali për
6 çfarë bëhet fjalë. Shkojmë në faqen tjetër.

7 PY. Duke mbajtur parasysh dhe korrigjimet dhe sqarimet që na
8 dhatë javën e kaluar, dhe që i hodhëm në këtë shënim,
9 informacioni që keni dhënë në deklaratën tuaj për Mbrojtjen e
10 Thaçit, a është i saktë dhe i vërtetë me aq sa besoni dhe
11 kujtoni?

12 PË. Po.

13 PY. Duke mbajtur parasysh korrigjimet dhe sqarimet që janë
14 hedhur në këtë shënim, informacioni që keni dhënë në
15 deklaratën tuaj si dëshmitar për Mbrojtjen e Thaçit, a
16 pasqyron saktësisht atë që do të thonit sot nëse do t'ju bënin
17 të njëjtat pyetje në sallën e gjyqit, sikurse jua kanë bërë
18 kur keni dhënë deklaratën?

19 PË. Po.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkojmë pranimin e dokumentit në
21 fjalë me numër DHT12546, dhe DHT12556, dhe provat materiale
22 shoqëruese që janë pranuar përkohësisht nga Trupi Gjykues në
23 vendimin F03558, paragrafët 26 dhe 42(d). Dhe po ashtu
24 kërkojmë pranimin e Shënimit Përgatitor numër 1, me DHT12595,
25 96, për pranim.

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 11

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

2 kundërshtime nga Prokuroria?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ekipet e

5 tjera të Mbrojtjes? Nuk ka atëherë kundërshtime.

6 Dokumenti DHT12546, DHT12556 dhe DHT12596 pranohen dhe do

7 të marrin numrin përkatës të provës materiale.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti me numër

9 DHT12546, 12556, do të marrë numrin e provës 1D00430, dhe ka

10 klasifikim konfidencial.

11 Shënimi Përgatitor 1 që është DHT12595, deri në DHT12596,

12 do të marrë numrin e provës materiale 1D00431, dhe ju lutem,

13 më sqaroni klasifikimin e dokumentit në fjalë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se deklarata përmban të

15 dhëna që janë të mbrojtura sipas rregullës 107, kështu që do

16 të duhet të mbetet konfidenciale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po Shënimi Përgatitor

19 numër 1, konfidencial?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, konfidencial -- do ju kthej

21 përgjigje përfundimtare pak më vonë. Besoj se -- duhet të jetë

22 konfidencial, por do t'jua konfirmoj pak më vonë këtë gjë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,

24 atëherë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

1 PY. Më 14 nëntor 2025 Mbrojtja e Thaçit dorëzoi me email një
2 përmbledhje të këtij dëshmitari që është pranuar sipas
3 rregullës 154 për Trupin Gjykses, palët dhe pjesëmarrësit. Nuk
4 morëm asnjë kundërshtim për këtë përmbledhje, kështu që ju
5 lutem të më lejoni ta lexoj përmbledhjen.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKSES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 Gjenerali Clark është një gjeneral i dekoruar i Ushtrisë
9 së Shteteve të Bashkuara që ka shërbyer si komandant i forcave
10 aleate në Evropë sipas Organizatës së Atlantikut Verior nga
11 1997 deri në vitin 2000. Gjenerali Clark do të japë dëshmi për
12 përpjekjet e NATO-s për të zbatuar marrëveshjen Holbrooke-
13 Milosheviq nga tetori i 1998 dhe për rezolutën e Kombeve të
14 Bashkuara 119 [Sipas përkthimit], do të flasë për fushatën
15 ajrore kundër forcave jugosllave pas refuzimit të Milosheviqit
16 për të nënshkruar marrëveshjen e Rambujesë, dislokimin e
17 forcave në Kosovë në përputhje me marrëveshjen teknike-
18 ushtarake dhe rezolutën e OKB-së 1244, dhe për procesin e
19 demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së.

20 Gjenerali Clark deklaroi se askush në komandën, zinxhirin
21 hierarkik të NATO-s nuk mendoi se do të vazhdonte konflikti i
22 armatosur pas qershorit 1999. Po ashtu, do të përshkruajë se
23 ka qenë në dijeni për valën e dhunës në verën e 1999, pas
24 kthimit të refugjatëve Kosovarë në vendin e tyre, dhe i
25 atribuon dhunën faktorëve të ndryshëm, përfshirë urrejtjen,

1 hakmarrjen, gjakmarrjen, edhe bandat kriminale.

2 Gjenerali Clark nuk besonte se udhëheqja e UÇK-së ka qenë
3 e angazhuar në këto akte dhune kundër serbëve apo pakicave,
4 dhe as z. Thaçi konkretisht nuk ka pasur motiv për t'u
5 përfshirë në sjellje të tilla, në veprimtari të tilla.

6 Së fundi, Gjenerali Clark do të përshkruajë komunikimet e
7 ndryshme që ka pasur me UÇK-në, delegacionin shqiptar të
8 Kosovës në Rambuje, dhe konkretisht me z. Thaçi. Ai deklaron
9 se nuk e ka parë, nuk e ka konsideruar UÇK-në si një
10 organizatë të strukturuar mirë, me funksionin nga lart poshtë,
11 apo që të kishte strukturë komande dhe kontrolli. Ai po ashtu
12 ka parë se mungonte kontrolli në fakt dhe z. Thaçi nuk kishte
13 kontroll ndaj UÇK-së, dhe se ai ka qenë thjesht një figurë
14 politike pa përvojë ushtarake, dhe që kishte influencë të
15 kufizuar ndaj ushtarëve të UÇK-së.

16 Bazuar në përgjegjësinë e përgjithshme të Gjeneralit
17 Clark, dhe konstatimet e tij të drejtpërdrejta, ai beson se
18 është e padrejtë t'i atribuohet, t'u atribuohen gabimet e të
19 tjerëve z. Thaçi.

20 Me kaq mbyll përmbledhjen.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Duhet të bëjmë një pushim të shkurtër për përkthyesit.

24 Dhe kini parasysh që të dy flasim anglisht, edhe gabimisht

25 flasim shumë shpejt me pyetje-përgjigje pa pauzë. Kështu që,

1 unë duhet t'i kujtoj dhe vetes që të bëj një pauzë mes
2 pyetjeve-përgjigjeve. Do ju lutesha dhe ju që përpara se të
3 përgjigjeni të prisni një çast, në mënyrë që të ketë mundësi
4 të realizohet përkthimi, dhe që stenografi të zbardhë të
5 gjithë dëshminë tuaj siç duhet. Ju faleminderit.

6 Do të filloj me disa pyetje për të shkuarën tuaj, se kush
7 jeni ju.

8 Së pari, sikurse keni thënë në deklaratën tuaj, ju keni
9 përfunduar studimet në West Point në 1966, keni qenë një nga
10 nxënësit më të shkëlqyer të klasës tuaj, dhe më pas ju u bëtë
11 një Shkollar në Oksford, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Më pas shkuat në ushtrinë e -- për 34 vjet në ushtrinë e
14 Shteteve të Bashkuara të Amerikës ku keni qenë një gjeneral me
15 katër yje dhe më pas keni qenë komandanti suprem i forcave
16 aleate në Evropë, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Ju keni qenë po ashtu kreu i komandës të Shteteve të
19 Bashkuara të Amerikës në Evropë, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Keni qenë komandanti për Evropën nga 1997 deri në vitin
22 2000, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Në deklaratën tuaj thoni se para kësaj keni qenë
25 negociatori kryesor për marrëveshjen e paqes në Dejton në

1 1995, në cilësinë e Drejtorit si për Planifikim Strategjik dhe
2 Politik në Pentagon. A mund të na tregoni çfarë detyrash ka
3 Drejtori i Planifikimit Strategjik dhe Politikave?

4 PË. Kam qenë përgjegjës për politikat ushtarake të SHBA-së
5 dhe strategjinë në gjithë botën. Pra, gjatë kohës time, kemi
6 pasur probleme me Saddam Hussein gjatë punës sime në Irak, kemi
7 pasur krizën e drogës, kemi pasur luftën që vazhdonte në
8 Bosnjë, kemi pasur krizën me Korenë ku gati filloi një luftë
9 në Kore, dhe kështu me radhë.

10 Po ashtu, do të duhej të rishkruanim strategjinë
11 ushtarake të Amerikës, pas luftës së ftohtë ne nuk kishim një
12 strategji ushtarake, kështu që nga 1994 ne filluam të
13 shkruanim një strategji të re dhe më pas u rishikua kjo pas
14 vitit 2000.

15 PY. Faleminderit. Në deklaratën tuaj, në paragrafin 5, thoni
16 që gjatë negociatave të Dejtonit në 1995, ju përmendët se
17 kishit dijeni se presidenti George Bush kishte dhënë një
18 paralajmërim të ashtuquajtur paralajmërimi i Krishtlindjes. Na
19 sqaroni çfarë është?

20 PË. Fillimisht, kur filluam negociatat, unë nuk kam qenë në
21 dijeni të këtij paralajmërimi, dhe diplomatët e dinin në fakt
22 këtë gjë. Por, publiku në përgjithësi dhe ne që punonim në
23 ushtri që kishim qenë të dislokuar në vende të tjera në
24 dhjetor të 1992 nuk kishim dijeni për shkak të dhunës që ishte
25 shënjestruar ndaj popullatës shqiptare nga policia serbe, dhe

1 nga MUP-i në veçanti, brenda Kosovës, Presidenti Bush, pra
2 George H. Bush, iu drejtua Milosheviqit dhe i tha që duhet ta
3 ndalonte menjëherë dhunën ose përndryshe SHBA-ja do të
4 kundërpërgjigjej. Ishte një referencë që përdorej nga forcat
5 ushtarake për të ndaluar represionin, dhunën, ndaj shqiptarëve
6 të Kosovës që ishin në fakt shumica e popullsisë në Kosovë.
7 PY. Ju po ashtu thatë që ju e kontaktuat Milosheviqin në
8 Dejton dhe trajtuat çështjen e trajtimit të tij të shqiptarëve
9 të Kosovës, dhe ai tha se nuk donte të fliste për këtë aspekt,
10 apo jo?
11 PË. Unë dhe Richard Holbrooke kontaktuam dhe ai tha "Nuk do
12 të flas për këtë. Është shteti im, problemi im". Refuzoi të
13 fliste për këtë temë. U përpoqëm më shumë se një herë në fakt.
14 Ne e dinim që ishte e rrezikshme kjo gjë, e dinim që atje
15 kishte vështirësi, por ai nuk donte të fliste për këtë gjë.
16 PY. Në rregull. Në paragrafin 6 të deklaratës suaj thoni se
17 filluat të fokusoheshit në Kosovë në gjashtëmuorin e parë të
18 1998, kur morët raportime për sulmin e serbëve ndaj familjes
19 Jashari në Kosovë. Çfarë keni parë ju?
20 PË. Unë shkova në Maqedoni, më duket se kanë qenë ditët e
21 para të marsit, isha në Maqedoni. Kishim një task-forcë
22 amerikane të vendosur në Maqedoni, që ishte vendosur para disa
23 vitesh, për qëndruar në kufirin mes Serbisë dhe Maqedonisë.
24 Quhej Task-Forca Able Sentry. Unë nuk kisha qenë asnjëherë,
25 shkova ta inspektoja, kam qenë komandanti i kësaj pike për

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 17

1 rreth gjashtë muaj, shtatë muaj, shkova atje. Menjëherë më
2 merr në telefon ambasadori amerikan në Shkup, Chris Hill,
3 konkretisht, dhe më thotë, "Duhet të flisni menjëherë me
4 Presidentin Gligorov të Maqedonisë".

5 Kisha dëgjuar raporte se ishte vrarë familja e Jasharëve,
6 kishte shqetësime për këtë gjë. Por kur shkova të takoja
7 Presidentin Gligorov ai më shpjegoi se tani do të fillojë një
8 konflikt për shkak të kësaj, kjo vrasje do të nxisë një
9 konflikt.

10 Ai më tha, më tha, "Shqiptarët do të kundërpërgjigjen.
11 Nuk do ta pranojnë këtë që ndodhi. Shqiptarët do t'i
12 rezistojnë, do t'i kundërpërgjigjen kësaj vrasjeje".

13 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Seancës të
14 nxjerrë në ekran provën materiale 1D00430.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë e njihja Presidentin Gligorov
16 që prej periudhës së Dejtonit. Ishim takuar disa herë me të në
17 Shkup. Gligorovi ishte një person i arsimuar, kishte studiuar
18 në Universitetin e Beogradit në 1939, fliste anglisht,
19 gjermanisht, serbisht, frëngjisht. Ishte shkollar i vjetër, me
20 përvojë. Dhe ishte një person që e kuptonte shumë thjesht
21 situatën, qoftë si pjesëmarrës, qoftë si vëzhgues. Dhe ai po e
22 kuptonte se çfarë po ndodhte në Evropën Juglindore. Prandaj
23 për mua ishte një person i besueshëm, edhe unë ia mora
24 seriozisht ato që më tha.

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

1 PY. Kemi në ekran deklaratën tuaj.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja të shihnim paragrafin 7
3 të deklaratës suaj.

4 PY. Gjeneral, në këtë pjesë të deklaratës suaj, flisni për
5 faktin që pas kësaj, pra pas ngjarjes së familjes Jashari --

6 PË. Nuk ju dëgjoj mirë, ju lutem ngrini zërin.

7 PY. Në paragrafin 7, ju flisni që pasi, thoni që pasi u
8 takuat me Presidentin Gligorov të Maqedonisë, filluat të
9 përgatisnit një plan veprimi. Çfarë ishte ky plan veprimi, pse
10 e përcaktuat këtë plan veprimi?

11 PË. Pasi u takova me Presidentin Gligorov, kontaktova
12 menjëherë Pentagonin t'i njoftoja Pentagonin dhe personelin
13 përkatës atje dhe t'i paralajmëroja që Milosheviqi do të
14 krijonte një konflikt të ri, do të çelte një konflikt të ri,
15 dhe u sugjeroja që mbase duhej përsëritur paralajmërimi i
16 ashtuquajtur i Krishtlindjes i 1992.

17 Në këtë pikë, Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja thanë: Por
18 ne s'kemi asnjë politikë për Kosovën. Dhe gjatë periudhës
19 mars-prill 1998, sulmet serbe ndaj popullatës në Kosovë u
20 rritën gjithnjë e më shumë, u përshkallëzuan deri në pikën sa
21 ministrat e jashtëm filluan të flisnin me Sekretaren e Shtetit
22 amerikane për këtë problem. Dhe unë mendoja se e dija se
23 ç'duhej bërë në këto kushte. Por sipas procedurave të NATO-s
24 nuk kishim asnjë autoritet pa pasur udhëzime politike,
25 s'kishte plane konkrete.

1 Fola me Sekretaren amerikane të Shtetit për këtë, nuk kam
2 folur me asnjë ministër të jashtëm për këtë çështje. Më
3 udhëzuan Shtetet e Bashkuara të mos flisja me askënd tjetër.
4 Por -- po mendoj se ajo që ndodhi, nëse më kujtohet tamam
5 është që takimet ministrore, ministeriale, në pranverë, mbase
6 maj të 1998, më kërkuan atje të përgatisja një plan. Nuk e di
7 a kanë qenë ministrat e jashtëm apo ministrat e mbrojtjes. Por
8 aty lindi udhëzimi që të përgatitej një plan.

9 PY. Në paragrafin 7 ju thoni që në këtë plan përfshihet
10 gjithashtu dhe një urdhër aktivizimi.

11 PË. Kur je pjesë e NATO-s, zinxhiri i komandës është i
12 dyfishtë. Nga njëra anë unë i raportoja komisionit të
13 ushtrisë, por gjithashtu edhe Sekretarit të përgjithshëm, por
14 në të njëjtën anë i referoja punën time edhe ministrave të
15 mbrojtjes. Për shembull, unë u ktheva te kryesia e shefave të
16 përbashkët dhe iu shpjegova cilat ishin opsionet, çfarë mund
17 të bëja. Dhe gjithashtu, mora lejen e tij që të mund të flisja
18 me Shtëpinë e Bardhë lidhur me këtë çështje. Kështu që vijova
19 më tej duke biseduar me Shtëpinë e Bardhë. Në atë moment
20 filloi të zhvillohej plani. Pra, së pari më duhej që të merrja
21 lejen nga Shtetet e Bashkuara për të hartuar njëri-tjetrin
22 plan të NATO-s sepse i takonte që shumë asete, shumë zëra të
23 Shteteve të Bashkuara do të ishin pjesë e këtij plani.

24 Pra, filloi me një ide që do të demonstronte kompetencën
25 dhe fuqinë e Shteteve të Bashkuara për të vijuar me sulmet mbi

1 Serbinë, dhe kishte një lloj zhvillimi në goftë se ky spastrim
2 do të vazhdonte më tej, atëherë i takonte që ne do të
3 vazhdonim me fushatat bombarduese në Kosovë, dhe në goftë se
4 Milosheviqi nuk do të bindej, atëherë do të vazhdonim me
5 bombardimet në Serbi. Dhe në goftë se as kjo nuk do të
6 funksiononte, kishim dhe opsione për të shkuar në rrugë
7 tokësore.

8 Mënyra se si e hartova unë këtë plan ishte e tillë. Kur
9 kisha biseduar me Milosheviqin në Dejton dhe me të në fakt kam
10 folur disa herë gjatë Dejtonit. Ndonjëherë ka ndodhur që të
11 ketë qenë edhe dikush tjetër, të ketë qenë delegacioni, ose
12 ndonjëherë kam biseduar dhe vetëm, vetëm për vetëm me të, nën
13 udhëzimin e Richard Holbrooke. Në një prej takimeve që kam
14 pasur me të ai më tha, "Ne serbët nuk kemi asnjë shans kundër
15 NATO-s, sepse ju jeni NATO, jeni shumë të fuqishëm", e të
16 tjerë e të tjerë, edhe ai po ankohej domethënë për këtë
17 situatë. Por unë e dija që ai ishte disi "i frikësuar" sa i
18 takon fushatave ajrore të NATO-s.

19 PY. Faleminderit, Gjeneral. Në periudhën 1998, a keni qenë
20 tërësisht i përfshirë në atë çfarë ka ndodhur në Kosovë?

21 PË. Po. Ka qenë një periudhë e dhimbshme sepse më kujtohet në
22 një pikë, një brigadier nga ushtria shqiptare erdhi për t'u
23 takuar me mua. Ai më tha, "shikoni se cila është situata në
24 Kosovë", ndërkohë që ne shihnim se cilat ishin rrethanat,
25 sepse në fakt po hidhnin mortaja, bomba dhe po luftonin në të

1 gjitha format e mundshme në fshatrat shqiptarë. Dhe flitej për
2 të njëjtin person, flitej për të njëjtin proces.

3 PY. Faleminderit, Gjeneral.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të shohim bashkërisht
5 paragrafin 9 të deklaratës.

6 PY. Këtu, Gjeneral, ju thoni që në verën dhe në fillimin e
7 vjeshtës së 1998, sulmet mbi shqiptarët e Kosovës nga serbët u
8 intensifikuan. Dhe kjo çoi në shqiptarët e Kosovës që u
9 larguan nga shtëpitë e tyre, duke shkuar fillimisht në
10 fshatrat aty afër dhe më pas nëpër bjeshkë.

11 Ndërkohë në paragrafin 10 ju thoni se cili ishte
12 përfundimi i marrëveshjes ndërmjet Holbrooke dhe Milosheviqit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretarit të kalojë
14 më poshtë në tekst për të lexuar tekstin.

15 PY. Pyetja e parë që kam për ju është kjo, a ju kujtohet
16 qëllimi i përgjithshëm, dhe kushtet e përgjithshme të
17 kontratës së tetorit me Milosheviqin?

18 PË. Qëllimi i përgjithshëm ishte që t'i vihej fund dhunës,
19 dhe që Milosheviqi të tërhiqte forcat ushtarake nga Kosova.
20 Atje kishte tri ose katër regjimente të ndryshme. Pra, ishte
21 policia ushtarake, një brigadë e policisë ushtarake. Në mos
22 gabohem, ekzistonte gjithashtu edhe një regjiment i armatosur,
23 domethënë, me fjalë të tjera, Milosheviqi kishte forca të
24 shumta të dislokuara në Kosovë, duke filluar nga pranvera e
25 1998, dhe duke vijuar më tej me verën. Ne i kishim parë këto

1 zhvillime.

2 Dhe kur Holbrooke u kthye për t'u takuar me Milosheviqin
3 në qershor të vitit 1998, ndoshta nga fillimi i korrikut,
4 fundi i qershorit, Holbrooke në atë kohë po priste konfirmimin
5 që të bëhej ambasador i Kombeve të Bashkuara në emër të
6 Shteteve të Bashkuara, dhe Presidenti e dërgoi atë për të
7 biseduar me Milosheviqin sepse ishim të gjithë shumë të
8 shqetësuar se çfarë po ndodhte në Kosovë. Pra, sigurisht që
9 edhe Shtëpia e Bardhë ishte e shqetësuar lidhur me këtë.

10 Holbrooke më mori mua në telefon. Ai ishte së bashkë me
11 Milosheviqin, dhe Milosheviqi tha që "i shikoj aeroplanët
12 tuaj, avionët tuaj, i shikoj që ata fluturojnë mbi Kosovë. I
13 shikoj avionët tuaj, por këta janë njerëzit e mi. Unë nuk do
14 t'i dëmtoj ata".

15 Pra, kjo ishte faza e parë e këtij operacioni të
16 kombinuar që filluam ne. Pra, ishte e qartë për ne që ai nuk
17 do na dëgjonte, dhe kjo qasje vazhdoi dhe u zhvillua më tej në
18 korrik dhe në gusht. Rreth 400 000 civilë shqiptarëve u
19 larguan nga fshatrat e tyre nëpër bjeshkë, nëpër male, ishin
20 fëmijë, me foshnja të vogla, persona të cilët ishin të gjithë
21 të frikësuar, por në pjesën dërrmuese serbët ishin ende shumë
22 të përqendruar tek fakti që donin që të eliminonin juristët e
23 mjekët në këto fshatra në vend që të ndiqnin njerëzit që po
24 shkonin nëpër bjeshkë. Pra, ata vazhdonin që të qëndronin aty.

25 Unë asokohe po udhëtoja nëpër Evropë dhe më kujtohet që

1 mora udhëzime nga burra shteti të ndryshëm nëpër Evropë. Njëri
2 prej tyre ishte Presidenti Meri i Estonisë. Ai më shpjegoi se
3 politikat e luftës guerile, dhe mënyra se si ishin zhvilluar
4 ato, kishin çuar në një luftë kundërguerile nga Bashkimi
5 Sovjetik. Gjithashtu, ai më tha që NATO e ka dhënë këtë
6 paralajmërim, Milosheviqi nuk po bën asgjë, nuk po bën asnjë
7 hap për t'iu përgjigjur këtij paralajmërimi, dhe NATO-ja po
8 humb besueshmëri çdo ditë e më shumë që kalon.

9 PY. Faleminderit, Gjeneral. Dua t'ju tërheq vëmendjen te pika
10 e tretë e dokumentit që keni përpara. Thuhet që një pjesë e
11 marrëveshjes bënte pjesë [Sipas përkthimit] për:

12 "Mbikëqyrje ajrore dhe verifikim nga NATO-ja dhe me
13 ish-Republikën e Jugosllavisë, domethënë që të rishikohej
14 pjesa e radarëve dhe sistemeve të mbrojtjeve ajrore të
15 ish-Republikës së Jugosllavisë, dhe ato duhej që të
16 largoheshin nga Kosova ose të vendoseshin në vende ose në
17 operacione të tjera ..."

18 Çfarë territore keni mbikëqyrur juve? Kjo është pyetja që
19 kam për ju aktualisht, Dëshmitar.

20 PË. Territorin mbi Kosovën.

21 PY. Kë mbikëqyrnit në veçanti?

22 PË. Po mundoheshim që të identifikonim në qoftë se bëhej
23 fjalë për spastrime etnike apo jo. Domethënë, shikonim
24 lëvizjet e MUP-it, të policisë së posaçme, të policisë së
25 rendit etj.

1 PY. A keni pasur mundësi që të mbikëqyrnit forcat e UÇK-së?

2 PË. Nuk kishte shumë gjë për të parë lidhur me UÇK-në, nuk

3 mund të bëhej gjë shumë lidhur me UÇK-në, sepse kryesisht

4 nëpër radio ose sa i takon zinxhirit të komandës, nuk mund të

5 thuash që kishin të bënë me dy forca paralele. Nuk mund të

6 identifikonim dy forca kundërshtare. Më lejoni të shpjegoj dhe

7 diçka tjetër, ju lutem. Ky paragraf mbulon shumë tema. Nga

8 fundi i shtatorit deri në fillim të nëntorit, ose në fillim të

9 dhjetorit, unë personalisht kam shkuar tri herë në Beograd. Në

10 njërën prej këtyre takimeve ka qenë me mua dhe Javier Solana,

11 dhe në këto takime jemi ulur me Milosheviqin, dhe Milosheviqi

12 na tha: "Unë do t'i tërheq këto forca". Dhe Solana në këtë

13 takim konkret më tha mua, "Cilat janë ato forca që nuk janë

14 tërhequr?", ndërkohë që unë u përgjigja duke thënë se "Cilat

15 ishin forcat e patërhequra?" Ai më pas i thotë Milosheviqit.

16 Milosheviqi i drejtohet Gjeneralit Perisic, ata po flisnin

17 serbisht, dhe nuk po kuptoja se çfarë po thonin me njëri-

18 tjetrin, dhe Milosheviqi na tha me inat që "Do i tërheqim dhe

19 ato". Domethënë, ishte me inat sepse ne e kapëm me diçka. Nuk

20 ishte e qartë në qoftë se ishte, u mërzit me neve që i vumë në

21 dukje këtë mangësi të tij, pra që nuk i kishte tërhequr të

22 gjitha forcat, ose në qoftë se ishte i inatosur me Perisic.

23 Dhe këtu u larguam. Ne menduam që ishte takim i

24 suksesshëm, por më pas asgjë nuk ndodhi. Forcat nuk u tërhoqën

25 asnjëherë. Shkova më tej në një tjetër takim pas një jave, i

1 thashë presidentit, "President Milosheviq, duhet të tërheqësh
2 forcat sepse në qoftë se nuk i tërheq forcat atëherë NATO-ja
3 do të më kërkojë që të ekzekutojë, të zbatojë planin që kemi
4 në letër dhe ne do të vazhdojmë bombardimin". Dhe ai u
5 përgjigj, "NATO-ja të bëjë atë çfarë ka për të bërë". Edhe unë
6 u përgjigja, "Ne nuk duam ta bëjmë atë çfarë mund të bëjmë".
7 Dhe ai më tha që, "Ke të drejtë, por bisedoni me Gjeneralët".
8 Kështu që unë shkova dhe bisedova me Gjeneralët. Dhe ndërkohë
9 që i tregova dhe hartën. Ata më thanë, që "Këta janë
10 terroristë, ja këta persona këtu, aty, janë të gjithë
11 terroristë, janë zona të Kosovës".

12 Dhe unë i thashë, "Nuk do e zgjidhësh kështu këtë bisedë
13 duke i quajtur të gjithë terroristë dhe duke i mundur, dhe
14 duke i shtypur njerëzit e Kosovës. Nuk mund të dëbosh njerëzit
15 nga shtëpitë e tyre dhe t'i thërrasësh të gjithë terroristë.
16 Duhet të ndryshosh taktikën tënde". Por as kjo bisedë nuk çoi
17 në asgjë. Kur u ktheva herën tjetër dhe shkova dhe e takova
18 Milosheviqin, ai më tha që do bënte çdo gjë që mundej, por
19 asgjë nuk ndodhi. Më pas, shkova në takimin e tretë me
20 Gjeneralin Klaus Marlin [Sipas përkthimit] në atë kohë, u ulëm
21 me të dhe i treguam Presidentit Milosheviq që çfarë donim ne
22 të bënte ai. Ai më tha që, "Personi që është përgjegjës është
23 z. Sainovic, me atë duhet të flisni". Kështu që, ai tha që nuk
24 ishte personi përgjegjës. Ne shpenzuam të gjithë darkën për të
25 shkruar marrëveshjen. Të nesërmen ishte e diel në mëngjes,

1 ishte koha për të nënshkruar marrëveshjen. Presidenti
2 Milosheviq erdhi në orën 10.00 në mëngjes dhe ai u soll sikur
3 marrëveshja ishte vërtet shumë e rëndësishme. Ai tha, "Ne e
4 dimë se si t'i trajtojmë këta shqiptarët, këta vrasës, dhe e
5 kemi bërë këtë gjë edhe më përpara, nuk është hera e parë".
6 Unë i thashë, "Z. President, po si i keni trajtuar ata, çfarë
7 keni bërë?" Ai m'u përgjigj, "I kemi vrarë të gjithë".

8 Dhe pastaj i paraqita marrëveshjen që ishte shtypur me
9 njerëzit e vet, ku ishin disa pika lidhur me çfarë do të bënin
10 Shtetet e Bashkuara, pra, sa i takon forcave tërheqëse dhe
11 negociatave. Unë i thashë, "Z. President, nuk e shikoj ta keni
12 nënshkruar këtë marrëveshje". Ai më tha, "Nuk është e
13 nevojshme". I thashë, "Sigurisht që është e nevojshme, duhet
14 ta nënshkruani". Dhe në fund ai e nënshkroi marrëveshjen. Ne u
15 kthyem përsëri mbrapsht. Ndërkohë, të nesërmen prapë asgjë nuk
16 ndodhi.

17 Kështu që unë mora në telefon ambasadorin e Shteteve të
18 Bashkuara në një linjë të hapur thirrjeje, dhe i thashë,
19 "Asgjë s'po ndryshon, është e njëjta situatë. Në qoftë se
20 gjërat nuk fillojnë të ndryshojnë deri në darkë më duhet që
21 t'i raportoj NATO-s dhe duhet që të vazhdojmë të zbatojmë
22 planin", çfarë do të thotë që duhet të ndërhyjmë në aspektin
23 ushtarak, pra duhet të fillojmë bombardimet. Në dy-tri orët
24 pasuese, asgjë nuk ndodhi. Gjërat, pra, filluan që të
25 ndryshonin pas dy-tre orësh nga ana jonë, por jo nga ana e

1 Milosheviqit.

2 Dhe, në këtë moment, Ambasadori Walker në Misionin
3 Verifikues Diplomatik në Kosovë, qëllimi kryesor i këtij
4 misioni ishte që Serbia të respektonte atë çfarë ishte rënë
5 dakord së bashku me Richard Holbrooke.

6 PY. Faleminderit. Të bëjmë një pauzë, se po flasim shumë
7 shpejt.

8 PË. Ndoshta jam pak më shpejt.

9 PY. Nuk ka problem, thjesht sa për të kapur ritmin.

10 Ju këtu thoni që Këshilli i Atlantikut Verior autorizoi
11 një urdhër aktivizimi për sulme ajrore të kufizuara që do të
12 ekzekutoheshin, pra, brenda 96 orëve kundër Serbisë.

13 Pyetja është kjo: Aktivimi i këtij urdhri hyri më datë 13
14 gusht 1998?

15 PË. Ky ishte urdhri i aktivizimit, që përbënte bazën mbi të
16 cilën mund të ndërhynim. Holbrooke kërkoi që të ekzekutohej,
17 që të zbatohet kur ai shkoi për të takuar herën e parë
18 Milosheviqin. Milosheviqi, pra, e kam këtu fjalën për takimin
19 e verës, ndërkohë që nuk u bë asgjë.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, pyetja thotë që
21 e keni fjalën për "gusht 1998". Kam përshtypjen që ka një
22 gabim aty se duhet të bëhet fjalë për "13 tetorin e 1998", apo
23 jo?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, keni të drejtë. Ju kërkoj
25 ndjesë për gabimin.

1 PY. [Nuk ka përkthim].

2 PË. Ajo çfarë është e rëndësishme është që pa një urdhër
3 aktivizimi NATO-ja nuk vepronte dot, nuk e zbatonte dot
4 marrëveshjen. Kështu që për këtë arsye, ishte e rëndësishme që
5 të kishim një urdhër aktivizimi për të ditur se cilat ishin
6 avionët luftarakë që do të kishim në dispozicion ne si NATO në
7 qoftë se do të vazhdohej me zbatimin e planit.

8 PY. Në verë dhe në vjeshtë të 1998, a jeni informuar nga
9 burime të ndryshme informacioni lidhur me situatën që
10 ekzistonte në terren në Kosovë?

11 PË. Po.

12 PY. Përveç se jeni informuar për pozicionin e forcave serbe
13 në terren, a keni marrë gjithashtu edhe informacione lidhur me
14 forcat e UÇK-së në terren në verën dhe vjeshtën e 1998?

15 PË. Jo shumë informacion.

16 PY. A ju kujtohet se çfarë informacioni keni pasur në 1998
17 lidhur me strukturën dhe komandën e UÇK-së?

18 PË. Nuk kishte shumë informacion, s'kishte shumë gjëra për të
19 folur sa i takon komandës. Me sa dinim ne, bëhej fjalë për
20 grupe lokale të cilat ishin formuar pak a shumë në mënyrë
21 spontane në përgjigje të shtypjes serbe prej shumë e shumë
22 vitesh. Në veçanti, pas vrasjes së familjes së Jasharëve, pra,
23 gjithmonë e më tepër pra filloi që të krijohej një alarm i
24 përgjithshëm që do të kishte gjithnjë e më shumë zhvillime
25 negative, dhe për këtë arsye njerëzit gjithmonë e më tepër po

1 formonin këto grupe lokale. Me sa dinim ne, kaq dinim.

2 Unë sigurisht që mora më shumë informacion lidhur me
3 UÇK-në nga serbët, sesa kam marrë informacion nga forcat tona.
4 Serbët kishin pika të identifikuara në hartë që i kishin të
5 identifikuara si të ashtuquajtura pika terroriste. Domethënë,
6 ata po mundoheshin që të mblidhnin informacion lidhur me këtë.
7 Sigurisht që pjesa më e madhe e personave në këto grupe ishin
8 persona që kishin shtëpitë, familjet e tyre, që mundoheshin të
9 kishin jetën e tyre, por nga ana tjetër po përpigeshin që
10 gjithashtu të mbronin veten dhe familjen.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do doja që të shikojmë
12 paragrafin 17 të deklaratës tuaj.

13 PY. Këtu identifikoni masakrën e Reçakut.

14 PË. Po.

15 PY. Këtu ju thoni se keni pasur një takim me Milosheviqin
16 lidhur me këtë temë. Më tej, juve vazhdoni dhe thoni që e keni
17 zvogëluar kohën e njoftimit nga 96 orë në 48 orë. A na e thoni
18 dot arsyen se pse e keni bërë këtë gjë?

19 PË. Po mundohem që të lexoj këtë pjesën që sapo e përmendët,
20 por nuk e gjej gjëkund.

21 PY. Në paragrafin 19, do ju kërkoja të lexonit paragrafin pa
22 zë, ju lutem.

23 PË. Thjesht po përpigeshim që të ushtronim trysni mbi
24 Milosheviqin.

25 PY. Në rregull.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër të
2 deklaratës.

3 PY. Në paragrafin 22, flisni për takimin me z. Thaçi. Do ju
4 kërkoja të lexonit me mendje këtë takim.

5 PË. E keni fjalën për paragrafin 22?

6 PY. Po.

7 PË. Më lejoni të them shkurtimisht që mua m'u kërkuar që të
8 shkoja në bisedat në Rambuje sepse në qoftë se do shkoja atje,
9 mendohej që mund t'i bindja serbët që të pranonin
10 marrëveshjen. Pra, marrëveshja që nënshkruan në Rambuje ishte
11 pak a shumë e njëjta, ndiqte të njëjtën logjikë të
12 marrëveshjes që ne kishim hartuar në Bosnjë, domethënë me
13 fjalë të tjera ishte një thirrje e NATO-s, e Kombeve të
14 Bashkuara, për të ndaluar dhunën. Domethënë, nuk ishte se
15 kishte një plan tjetër më të elaboruar, por thjesht ishte një
16 plan që të kthenim paqen, të ndalonim dhunën.

17 Unë mendova se mund të shkoja në këto biseda, por nuk u
18 lejova që të shkoja atje.

19 Më në fund, mua m'u lejua që të shkoja dhe të takohesha
20 me shqiptarë të UÇK-së, domethënë, me delegacionin shqiptar të
21 UÇK-së. Kjo ka ndodhur në fundin e seancës së parë të bisedave
22 të paqes në Rambuje. E di që kam fluturuar atje, dhe u tregova
23 anëtarëve të delegacionit shqiptar të UÇK-së se çfarë plani
24 kishte NATO-ja. U thashë që ne e kishim përnjëmend planin
25 tonë, nuk e kishim sa për të larë gojën, dhe u tregova atyre

1 se cili ishte qëndrimi ynë.

2 Ndërkohë, pas disa ditësh, ata, pra delegacioni shqiptar,
3 e pranoi propozimin dhe serbët nuk e pranuan. Dhe kjo për ne
4 ishte një bazë për të filluar diçka.

5 U takova me z. Thaçi një herë të dytë, përpara se sa
6 filluan fushatat bombarduese nëse nuk e kam gabim. Ai ishte
7 një prej personave atje. Ishte personi më me autoritet, ishte
8 më i riu, ishte më bindësi, pra ishte personi që ishte i
9 veshur më mirë, i kishte flokët në mënyrën më të përshtatshme,
10 me ç'e kuptova unë ai jetonte në Zvicër, fliste gjermanisht,
11 nuk fliste shumë anglisht asokohe. Unë ndërkohë nuk është se
12 flisja shumë gjermanisht kështu që ishte pak e vështirë që të
13 komunikoj me njëri-tjetrin, por ai nuk ishte komandanti
14 ushtarak.

15 PY. Ju në paragrafin 23 të deklaratës thoni që ju arritët në
16 përfundimin që nuk ishte komandanti ushtarak sepse ai nuk ju
17 ndihmoi për të identifikuar objektiva, dhe që nuk e kishte
18 fare idenë ose as kuptim bazik të operacioneve ushtarake, apo
19 jo?

20 PË. Është e saktë. Kur u takova me të herën e tretë, unë
21 kërkova ndihmë, por nuk morëm asnjë ndihmë sepse ai nuk e
22 kishte idenë fare se çfarë po ndodhte. Edhe unë thashë,
23 domethënë, ku, çfarë po ndodh. Se problemi që kisha unë si
24 komandant ishte që ne nuk kishim një folës në terren, kështu
25 që ne mbështeteshim vetëm, do të mbështeteshim vetëm thjesht

1 në fushatat ajrore. Donim që të mos sulmonim objektivat
2 civile, por donim vetëm thjesht që të ndërhyjmë në forcat
3 ushtarake në terren. Dhe pyetja që i bëra unë është, ku janë
4 ata, ku jeni ju? Pra, çfarë duhet të sulmoj unë, cilat janë
5 objektivat e mi? Ndërkohë që përgjigjja që mora prej tij
6 ishte, asgjë.

7 PY. Faleminderit, Gjeneral. Në paragrafët 24 dhe 25 të
8 deklaratës suaj, ju thoni se nuk besoni që UÇK-ja kishte
9 ndonjë strukturë kontrolli dhe komande funksionuese. Pyetja që
10 kam për ju është kjo. Cila është dallimi ndërmjet kontrollit
11 dhe komandës?

12 PË. Ne gjithmonë themi komandë dhe kontroll, sepse komanda
13 është kompetenca, autoriteti, por kontrolli është mënyra për
14 ta mbikëqyrur atë, për t'u përgjigjur ndaj situatës, për ta
15 korrigjuar atë, për ta udhëzuar atë, dhe për të ndjekur hapat.
16 Me aq sa pamë ne, nuk kishte asnjë prej këtyre elementëve.

17 Ne kishim disa vëzhgues në kufirin midis Shqipërisë dhe
18 Kosovës, dhe ndonjëherë ata më thonin që mundoheshin që të
19 mblidhnin informacion. Këtu e kam fjalë për persona që i
20 përkisnin forcave speciale të Shteteve të Bashkuara, por as
21 ata nuk patën mundësi që të mblidhnin informacion të
22 besueshëm. Ishte e qartë që bëhej fjalë për grupe të pavarura.
23 Ishin grupe të cilët ishin të motivuara, ishin duke luftuar.
24 Ndonjëherë ata kapnin dikë. Për shembull, në një pikë ata
25 kapën një rus edhe unë thashë që nuk është se jam i interesuar

1 për këtë gjë.

2 Domethënë, me fjalë të tjera nuk kishte mënyra
3 komunikimi, ishin thjesht njerëz të vetorganizuar. Unë nuk
4 kisha asnjë dyshim që ushtria serbe ishte e frikësuar prej
5 tyre, por nga ana tjetër sa i takon komandës dhe kontrollit
6 ose sa i takon një force të koordinuar, asnjëra prej këtyre
7 nuk ekzistonte. Të paktën, jo sipas mendimit tim, me aq sa kam
8 parë unë.

9 PY. Gjeneral, a jeni munduar ndonjëherë që të eksploroni
10 mundësitë që të mbështeteshit në UÇK-në si një formë trupash
11 në terren?

12 PË. Jemi përpjekur, këtë doja unë. Domethënë, ishte shumë e
13 rëndësishme për neve që të mbështetshim në mënyrë të tillë që
14 të mos bënim gabime.

15 Për shembull, në një rast kemi identifikuar disa
16 automjete serbe rreth një ndërtese që dukej sikur ishte një
17 seli ose një shtab, ishin automjete që ishin rreth e kësaj
18 ndërtese. Kishte antena në godinë, kishte komunikime. Dhe
19 personat që punonin për inteligjencën e identifikuan atë si
20 një godinë serbe, dhe u godit, dhe pastaj doli që s'ishte fare
21 godinë serbe. Serbët aty kishin vendosur shqiptarë dhe ajo
22 ishte një godinë në të cilën ekzistonte një zonë ku ishin të
23 ndaluar shqiptarët, ku serbët i kishin futur shqiptarët aty
24 për t'i ndaluar. Dhe ishte një incident i tmerrshëm, dhe unë
25 dhe njerëzit e mi vërtet u ndiem shumë keq kur zbuluam se

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 34

1 çfarë kishte ndodhur në realitet.

2 Domethënë, ky është një shembull për t'ju ilustruar juve
3 që ne nuk kishim asnjë lloj informacioni lidhur me atë se
4 çfarë po ndodhte në terren.

5 PY. Faleminderit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
7 paraqesë në ekran provën 1D00102.

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Ju lutem, flisni pak me zë më të
9 lartë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Po flisja me Sekretarin, ju kërkoj
11 ndjesë, Gjeneral.

12 PY. Gjeneral, ajo çfarë shikoni në ekran është një letër që
13 është dërguar nga Departamenti i Shtetit që mban datën 4 maj
14 1999. I është drejtuar Kryetarit të Senatit, Mitch McConnell.
15 Dua t'ju bëj një pyetje lidhur me atë çfarë i ka thënë
16 Departamenti i Shtetit z. McConnell. Është një letër e cila ka
17 të bëjë me anëtarët e Senatit Amerikan që të armatosnin
18 UÇK-në. Në atë kohë, a keni qenë i informuar për ndonjë
19 iniciativë, ose synim, të Shteteve të Bashkuara, të Kongresit,
20 pra, për të armatosur UÇK-në?

21 PË. Nuk e di, mbase e kam ditur këtë gjë në atë kohë, por në
22 atë kohë kam qenë shumë i përfshirë për të përgatitur
23 bombardimet ajrore edhe për të ushtruar trysni mbi Serbinë,
24 për të bërë hapat e veta. Besoj që kjo mund të jetë diçka që
25 mund të ketë qenë në linjë me të njëjtat veprime, por nuk e

1 di.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Në paragrafin 3.

3 PY. Departamenti i Shtetit i tregon z. McConnell që:

4 "... në Kosovë nuk ka një forcë me komandë dhe kontroll
5 real në Kosovë...", domethënë, i referohet UÇK-së këtu.

6 A pajtoheni me këtë vlerësim të kongresit , Gjeneral?

7 PË. Po.

8 PY. Kur thuhet që "nuk ka strukturë politike në Kosovë", a e
9 besoni edhe juve që nuk ka pasur strukturë politike në Kosovë
10 në atë kohë?

11 PË. Unë e dija, isha në dijeni për z. Rugova që më përpara
12 kishte qenë në burg disa herë, por e dinim që ai kishte një
13 pasues në Kosovë. Megjithatë, nga ana tjetër, e dinim që
14 struktura nuk është efektive, dhe në qoftë se më lejoni të
15 vazhdojmë më tej, nuk është se edhe në qoftë se ekzistonte kjo
16 si fuqi, nuk ishte e lidhur me rezistencën e armatosur. Ishte
17 komplet e veçantë, e ndarë.

18 PY. A keni pasur ndonjë vlerësim në qoftë se ka pasur ndonjë
19 kontroll civil mbi UÇK-në?

20 PË. Jo, nuk ka pasur.

21 PY. A do ketë qenë e mundur për UÇK-në që të ketë pasur një
22 zinxhir komandues funksional me hierarki të plotë dhe që në
23 NATO-ja dhe Shtetet e Bashkuara të mos e kenë ditur këtë gjë?

24 PË. Absolutisht jo.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të

1 paraqesë edhe një herë në ekran deklaratën e Gjeneralit. Të
2 kalojmë në paragrafin 27.

3 PY. Gjenerali Clark, në paragrafin 27 që është në ekran tani
4 ju thoni që konflikti në Kosovë, konflikti i armatosur në
5 Kosovë përfundoi me tërheqjen e forcave serbe në bazë të
6 marrëveshjes tekniko-ushtarake të qershorit 1999, dhe
7 miratimin e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara 1244.

8 Gjithashtu thoni që nuk kishte zinxhir komandues
9 përfshirë në Këshillin e Atlantikut të Veriut, pra, që -- ku
10 perceptohej që konflikti i armatosur kishte vazhduar pas
11 qershor 1999.

12 Pra, nuk ishte kështu. Së pari, më lini, a mund të na
13 tregoni kur u fut KFOR-i në Kosovë, si ishte i strukturuar? A
14 ju kujtohet sa zona ishin aty?

15 PË. Ne kishim dy forca të NATO-s. Njëra në Shqipëri nën
16 komandën e Gjeneralit Reith e cila merrej me përafërsi një
17 milionë njerëz që ishin larguar nga vendi, afërsisht një
18 milionë, 500 000 njerëz, themi, në Shqipëri. Ata kishin një
19 mision për refugjatët. Në Maqedoni ne kishim trupat e
20 ndërhyrjes së shpejtë, të reagimit të shpejtë, nën komandën e
21 Gjeneralit Jackson. Pra, ai mori delegacionet kombëtare,
22 kishim italianët, kishim francezët, gjermanët, dhe kështu me
23 radhë, që ishin vendosur aty, dhe gati për të hyrë në Kosovë
24 në momentin kur rezoluta do të ishte e plotë.

25 Pra, nëse më kujtohet saktë, rezoluta është nënshkruar të

1 enjten në Nju-Jork, më 10 qershor, rreth mesditës, dhe serbët
2 duhej të largoheshin më datë 11, dhe NATO-ja duhej të
3 ndërhynte, të futej në Kosovë më 12 qershor. Pra forcat e
4 NATO-s ishin aty dhe të përgatitura dhe duke u planifikuar për
5 të hyrë në Kosovë. Pra, marrëveshja ishte bërë pas disa ditësh
6 negociatash mes Gjeneralit Jackson që më përfaqësonte mua dhe
7 serbët në pjesën jugore të kufirit me Serbinë.

8 PY. Faleminderit, Gjeneral. Ju kujtohet sa trupa të NATO-s
9 ishin në Kosovë kur u fut NATO-ja?

10 PË. Ne mendoj që kishim planifikuar për rreth 20 mijë trupa,
11 diçka e tillë.

12 PY. A patët mbështetje ajrore?

13 PË. Po.

14 PY. Kishit mbikëqyrje nga ajri, pra, në Kosovë?

15 PË. Po.

16 PY. Cilat do të kishte qenë përgjigjja e KFOR-it në qoftë se
17 Serbia do të kishte, do të ishte përpjekur të sulmonte Kosovën
18 apo UÇK-në pas tërheqjes së forcave serbe nga aty?

19 PË. NATO-ja do të kishte rezistuar, do të kishte reaguar
20 natyrisht.

21 PY. Në qoftë se Serbia do të kishte bërë përpjekje për të
22 sulmuar Kosovën, apo UÇK-në, pas tërheqjes së forcave serbe, a
23 do të kishte shkuar kjo, çuar kjo, në një konflikt midis
24 Serbisë dhe NATO-s?

25 PË. Po.

1 PY. A kishte atyre rrezik të vërtetë sipas pikëpamjes suaj të
2 rifillimit të veprimeve armiqësore apo konfliktit pas
3 tërheqjes së forcave serbe?

4 PË. Mendoj se kishte, mundësia ishte e lartë që forcat serbe
5 të rifillonin veprimet armiqësore, por akoma kishim, nuk
6 mendoj që kishte mundësi të lartë që forcat sere të fillonin
7 veprime armiqësore. Për ne kishim akoma çështjen e pazgjidhur
8 të rusëve që ishin në aeroportin e Prishtinës, dhe ne ishim
9 habitur, pra, kapur si papritmas nga lëvizja e rusëve nga
10 Bosnja më datën 11 qershor dhe kishin shkuar në Prishtinë në
11 momentin e tërheqjes së forcave serbe. Pra, nuk mund të
12 përjashtohet asnjëherë përgjegjësia për mbrojtjen, nuk mund të
13 mos merret parasysh përgjegjësia për forcën mbrojtëse dhe
14 përmbushjen e misionit, që të jetë e pranishme. Pra, njëra
15 prej përgjegjësive ishte që ne të ishim të përgatitur në rast
16 se do të ndodhte diçka.

17 PY. Por ajo që po përpiqem të kuptoj është sa realiste, sa e
18 mundur ishte në të vërtetë që të bëhej një ofensivë serbe mbi
19 NATO-n kundër NATO-s, si e keni parë ju këtë, sa realiste
20 ishte në atë kohë?

21 PË. Nuk ishte shumë realiste, por nga ana tjetër si komandant
22 ishte vendi që të mos kapesha i papërgatitur, pra dhe që të
23 mos gjendesha në një situatë ku s'e kisha menduar këtë gjë që
24 mund të ndodhte.

25 PY. Faleminderit, Gjeneral.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani, z. Sekretar, mund të
2 kalojmë, të shfaqim në ekran provën materiale P04064, ju
3 lutem.

4 PY. Gjenerali Clark, në ekran është marrëveshja
5 tekniko-ushtarake midis KFOR-it dhe qeverisë së Jugosllavisë
6 dhe Serbisë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Pak më poshtë në fund të faqes, ju
8 lutem, mund të kalojmë në faqen tjetër, faqja e dytë.

9 PY. Dhe këtu përkufizohen dy terma:

10 "... Zona e Sigurisë Ajrore ... përkufizohet si një zonë
11 25 kilometra që shtrihet përtej provincës, përtej kufirit të
12 provincës së Kosovës deri në, 25."

13 Pjesa tjetër është:

14 "Zona e Sigurisë Tokësore ... që përshkruhet si një zonë
15 5 kilometërshe që shtrihet përtej kufirit të provincës së
16 Kosovës në pjesën tjetër të republikës së ish-Jugosllavisë."

17 Në qoftë se kalojmë pastaj në pikën (a):

18 "Për të krijuar një ndërprerje të qëndrueshme të
19 veprimeve armiqësore, në asnjë rrethanë forcat e
20 ish-Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Republikës së
21 Serbisë, nuk do të hyjnë apo të rihyjnë apo të qëndrojnë
22 brenda territorit të Kosovës, apo zonës së sigurisë tokësore
23 ... dhe zonës së sigurisë ajrore të përshkruar në paragrafët
24 3, neni 1, pa patur pëlqimin paraprak të shprehur qartësisht
25 të forcës së sigurisë ndërkombëtar, KFOR-it pra, të

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 40

1 komandantit të saj. Policia vendore do të lejohet të qëndrojë
2 në zonën e sigurisë tokësore”.

3 Pyetja ime tani për juve është, serbët e kundërshtuan
4 ndonjëherë zonën e sigurisë tokësore dhe ajrore rreth Kosovës?
5 PË. Jo, gjatë periudhës që më kujtohet.

6 PY. Faleminderit.

7 PË. Dhe ishin, ata ishin të zënë për tërhequr pajisjet e tyre
8 jashtë vendit dhe të grumbullonin dhe të riorganizojnë forcën
9 e tyre ushtarake.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, bazuar në kërkesën e
12 siguruesit të informacionit, kërkoj të kalojmë në seancë
13 private.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na kaloni në
15 seancë private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 41

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 42

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 43

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 44

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 45

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Z. Sekretar mund të

23 shfaqim në ekran DHT12601 deri në DHT12603. Pak më poshtë.

24 PY. Gjeneral Clark, ky është një raport i mediave i botuar në

25 gazetën *Irish Times*. Më duket se është i datës, rreth datës 8

1 qershor [Sipas përkthimit].

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Pak më poshtë.

3 PY. Flitet për rritjen jashtëzakonisht të madhe të dhunës
4 etnike midis grupeve serbe dhe shqiptare, "dje në qytetin, në
5 pjesën e veriut, pra, të Mitrovicës. Ditën e parë trupat
6 franceze të KFOR-it u vunë në test sa i takon tolerancës
7 etnike dhe hoqën, testuan, pra, nivelin e tolerancës etnike
8 dhe hoqën pengesat, barrierat që ndanin qytetin".

9 Pastaj thotë:

10 "Pak kohë pas, pak kohë më pas, një turmë prej 7000
11 shqiptarësh etnikë nën mbrojtjen e fuqishme të KFOR-it kishin
12 marshuar në mënyrë paqësore në lagjet serbe për herë të parë
13 për të shprehur theksuar dëshirën e tyre për t'u kthyer në
14 shtëpitë e tyre. Një përplasje filloi midis grupeve të serbëve
15 radikalë dhe shqiptarëve. Ata u pozicionuan ..." mund të
16 shkojmë pak më poshtë, "... në dy anët e urës së lumit Ibër,
17 që ndan qytetin në baza etnike dhe që ishte bllokuar nga
18 KFOR-i deri ditën e djeshme. Pati hedhje gurësh nga të dyja
19 anët, por trupat franceze u vendosën aty dhe ndaluan dhunën e
20 mëtejshme duke arrestuar shqiptarët e Kosovës që u përpoqën të
21 hidhnin një granatë dore".

22 Pyetja ime, a ju kujtohet ky tension në Mitrovicë?

23 PË. Nuk më kujtohet ky incident.

24 PY. A keni dijeni për ndonjë përplasje midis forcave të
25 UÇK-së dhe paraushtarakëve serbë në Mitrovicë në fillim të

1 qershorit [Sipas përkthimit] 1999?

2 PË. Nuk jam në dijeni të ndonjë përplasjeje midis
3 paraushtarakëve serbë dhe UÇK-së, por jam në dijeni se kishte
4 një, se ka patur një seri përplasjesh gjatë kësaj periudhe.
5 Nuk kam menduar asnjëherë që ka qenë UÇK-ja. UÇK-ja thuhet se
6 nuk ishte pjesë e kësaj. Por e dija që kishte shumë presion
7 nga të dyja anët që të përpiqeshin të nxirrte, të largonin
8 shqiptarët nga pjesa e veriut, e lumit Ibër.

9 Dhe më duket se kishit diçka me datat. Kjo është më 16
10 nëntor. Por cila është data e saktë e incident për të cilin po
11 flisni?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund të kthehem pak.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] A është në shtator?

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Jo, është në korrik. Mund t'ju tregoj datën.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Pak më poshtë ju lutem.

17 PY. Shiheni, data është 8 korrik 1999, kur kjo është botuar,
18 pra.

19 PË. Po.

20 PY. Pra, ka qenë përpara kësaj.

21 PË. Pra, ka qenë menjëherë pas hyrjes, një javë pas. Mendoj
22 që mund ketë -- jo, mendoj që mund të ketë qenë pas pesë javë,
23 ose diçka e tillë pasi ne kemi hyrë atë, pra trupat e KFOR-it
24 kanë hyrë. Ka patur shumë lëvizje të tilla si kjo, që po
25 bëheshin në atë kohë, sepse njerëzit përpiqeshin të pohonin

1 dhe të shfaqnin dhe të vendosnin dominimin e tyre. Pra, mendoj
2 që, nuk mendoj që ka qenë e organizuar. Nuk kam kuptuar kurrë,
3 nuk e kam ndier kurrë apo patur përshtypjen që kjo ishte e
4 organizuar nga UÇK-ja. Këto ishin grupe individuale dhe ka
5 përfunduar pastaj, ka patur shumë lëvizje të tilla ku njerëzit
6 përpigeshin të vendosnin autoritetin e tyre dhe spastrim etnik
7 në pjesën e veriut, në veri të lumit Ibër. Në nivel të tillë
8 që unë kam shkuar dhe kam takuar Ministrin e Jashtëm dhe të
9 Mbrojtjes francez, në fillim të tetorit. Kam shkuar tek
10 Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe i jam ankuar sepse ishte
11 një përpjekje, kishte një përpjekje të organizuar të serbëve
12 për të spastruar zonën në veri të lumit Ibër, ku Mitrovica
13 ishte e shqiptarëve.

14 Kam takuar Ministrin Richard i cili më tha, "Jo, ne u
15 kemi dhënë urdhër trupave franceze të mbrojnë serbët në atë
16 zonë, dhe t'i mbështesin ata". Pra, ne kemi patur ca
17 vështirësi lidhur me këtë. Por, kjo është mënyra se si trupat
18 e NATO-s funksionojnë. Ka një lloj autoriteti dhe pushteti që
19 i përket vetë autoriteteve kombëtare dhe pse janë nën
20 kontrollin dhe komandën e NATO-s. Pra, i kam bërë thirrje
21 atij, ai nuk e ka ndryshuar këto urdhra. Më vonë kam çuar
22 përforcime të tjera aty për të ruajtur mundësinë që shqiptarët
23 të mund të jetojnë aty.

24 Raportet që po merrja tregonin se doktorët shqiptarë në
25 spitale dhe njerëz të tjerë po detyroheshin të largoheshin nga

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 49

1 Serbia dhe po dëboheshin prej aty. Dhe mendova dhe kuptova që
2 ishin paraushtarakët serbë dhe forcat speciale serbe që po
3 bënë këtë gjë.

4 PY. Faleminderit.

5 PË. Kjo është mënyra se si Beogradi vepronte.

6 PY. Faleminderit.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, dorëzoj DHT12601 deri
8 në DHT12603 si provë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
10 kundërshtim?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo pranohet.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
14 provës materiale 1D00434, dhe klasifikimi është konfidencial.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë publike.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Klasifikohet
17 si publike.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Gjenerali Clark, në deklaratën tuaj që keni diskutuar
20 gjithashtu demilitarizimin e UÇK-së në verë të 1999, dhe në
21 paragrafin 31 të deklaratës suaj deklaroni se Gjenerali
22 Jackson në mënyrë të rregullt ka bërë takime me komandantin e
23 UÇK-së Çeku dhe komandantët e zonave të UÇK-së, me qëllim që
24 të zbatohej demilitarizimi i UÇK-së. Gjithashtu, keni
25 diskutuar një takim të tillë ku ju keni marrë pjesë ku

1 Gjenerali Jackson ju ka pyetur juve që të bashkoheshit, të
2 ishit pjesë në mbledhjen e Këshillit të Përbashkët për Zbatim
3 me qëllim që t'ju drejtoheshit, t'ju flisnit me komandantët e
4 zonave të cilët po kundërshtonin përpjekjet për të dorëzuar
5 tërësisht armët.

6 Pyetja ime është, a kuptuat arsyen se pse Gjenerali
7 Jackson nuk mund t'i thoshte thjesht Komandantit Çeku që të
8 nxirrte, të lëshonte një urdhër, për të plotësuar
9 demilitarizimin dhe pse ai pati nevojë që Komandanti Suprem i
10 Aleatëve në Evropë t'u drejtohej në mënyrë të drejtpërdrejtë
11 komandantëve, pra juve.

12 PË. Në fakt unë nuk e kam trajtuar këtë çështje kurrë me
13 Gjeneralin Jackson, por e dija që ai kishte vështirësi sepse
14 duke qenë që kishte luftuar, ata kishin luftuar individualisht
15 dhe e kishin bërë punën e tyre më të mirë dhe maksimumin për
16 të mbrojtur popullin e tyre dhe pas ridaljes, pra, të
17 shqiptarëve të Kosovës, kthimit të Kosovarëve, të shqiptarëve
18 të Kosovës në Kosovë, mendoj që UÇK-ja ishte në gjendje në atë
19 pikë që të kishte ndier mbështetjen e njerëzve, pra, që të
20 kishte një lloj organizimi.

21 Unë nuk e kisha takuar asnjëherë Gjeneral Çekun më parë
22 dhe pra mendoj që shqetësimi që ata kishin ishte se ata,
23 populli i tyre, ishte keqtrajtuar rëndë dhe ata kishin qenë
24 viktima të shtypjes, nuk ishin të sigurt nëse mund t'i besonin
25 NATO-s që NATO-ja t'i mbronte ata. Nuk kishin, padyshim që

1 kishin parë se si trupat UNPROFOR-i nën mandatin e UN-it në
2 Bosnjë disa vite më parë nuk kishte qenë shumë efektive në
3 mbrojtje, për të mbrojtur popullin e Bosnjës. Pra e kishin
4 edhe këtë përvojë. Mendoj se Gjenerali Jackson donte që unë të
5 shkoja aty si një garanci shtesë. Ata më kishin parë në
6 televizor, e dinin që unë isha Komandanti Suprem, dhe se unë
7 mund t'i ndihmoja ata që të kuptonin se pse duhej t'i
8 dorëzonin armët, dhe pra që mund të kishin një lloj, edhe të
9 mbeteshin pjesë e një organizate që do të vepronte në raste
10 katastrofash të natyrshme. Por u thashë atyre që nuk mund të
11 jeni të armatosur, nuk jeni ushtri. Kjo ka përfunduar tani.

12 Dhe ky ishte mesazhi që dhashë gjatë atij takimi, asaj
13 mbledhjeje dhe ata e pranuan atë.

14 PY. A e kuptuat arsyen se pse komandantët e zonave duhej të
15 ishin të pranishëm në këtë mbledhje?

16 PË. Bëjeni dhe një herë pyetjen?

17 PY. A e kuptuat arsyen se pse komandantët e zonave duhej të
18 ishin të pranishëm në takimin me juve?

19 PË. Mendoj se kjo ishte sepse ata, kuptova se ishte një
20 organizatë në nivel rudimentar, i thjeshtë akoma. Njerëzit,
21 mendoj unë, nuk ishte, pra, një organizatë, një ushtri e
22 organizuar, nuk ishte që kolonelët mund të jepnin urdhra
23 kapitenëve dhe kapitenët t'u jepnin urdhra pastaj togerëve.
24 Këta ishin grupe luftëtarësh të organizuar në nivel rajonal,
25 apo lokal, të cilët ishin grumbulluar mbledhur së bashku për

1 të mbrojtur komunitetin e tyre, bashkësitë e tyre. Dhe dikush
2 nga jashtë po përpiquej t'i ndihmonte ata që të merrnin armë.
3 Dikush u jepte atyre ndoshta dhe stërvitje, ju bënte
4 stërvitje, por nuk ka qenë diçka që ka funksionuar së bashku.

5 Pra, supozimi im apo përshtypja ime ishte që pasi u fut
6 NATO-ja aty, këta persona në fakt takoheshin, u takuan me
7 njëri-tjetrin, biseduan dhe nuk kishte ndonjë nënshtrim apo
8 respektim ndaj ndonjë autoriteti të caktuar. Këta njerëz ishin
9 akoma, thonin unë kam bërë pjesën time, kam rrezikuar jetën
10 time, nuk të lejoj ty që të më thuash të bëj këtë apo të bëj
11 atë, pra nuk besoj, nuk kam besim në këtë. Kështu lloj
12 gjërash, e kam fjalën. Duhet t'i kuptojmë këta njerëz, këtë
13 popullsi.

14 Ajo që Milosheviqi më kishte thënë mua ishte e vërtetë. E
15 kam fjalën, ata kishin vrarë njerëz, edhe ata kishin qenë
16 viktimat të një shtypjeje etnike sistematike për një periudhë
17 të gjatë, më shumë se një dekadë përpara kësaj, ku gjuha e
18 tyre nuk lejohej. Ata ishin detyruar jashtë, larguar nga puna
19 qeveritare. Gjuha shqipe nuk pranohej në shkolla dhe kështu me
20 radhë. Pra këta njerëz kishin luftuar, kishin rezistuar dhe
21 ishin në mendjet e tyre të pavarur, mendoj unë. Kjo ishte
22 përshtypja ime kur u takova me ta. Unë i pashë këto grupe, ata
23 ishin njerëz vendorë, lokalë që kishin rrezikuar jetët e tyre,
24 për të luftuar kundër shtypjes.

25 PY. Faleminderit, Gjeneral.

1 PË. Mendoj që ky ishte qëllimi i pranisë time në këtë
2 mbledhje.

3 PY. Faleminderit. Në paragrafin 31 të deklaratës tuaj, thoni
4 që në këtë takim me komandantët e zonave ju vërejtët se
5 z. Thaçi ishte i vetëm në njërin anë dhe nuk merrej parasysh
6 pra nga luftëtarët e UÇK-së. Dhe që kjo përforcoi pikëpamjen
7 tuaj, apo mendimin tuaj se ndikimi i z. Thaçi tek ushtarët e
8 UÇK-së ishte i kufizuar. A është kjo e saktë?

9 PË. Në qoftë se mund ta bëni pyetjen edhe një herë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shfaqim në ekran, është më
11 lehtë, të shfaqim në ekran dokumentin 1D00430, ju lutem.
12 Paragrafi 31.

13 PY. Gjeneral, ju lutem, lexoni paragrafin 31 vetë dhe më
14 thoni kur keni përfunduar që të kalojmë në faqen tjetër.

15 PË. Lexova paragrafin 31.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. A ju kujtohet që në këtë takim ju patë z. Thaçi që
20 qëndronte vetëm, ndërsa komandantët e zonave ishin rreth jush
21 dhe Gjeneral Çeku dhe kjo përforcoi mendimin tuaj se ndikimi i
22 z. Thaçi mbi UÇK-është ishte i kufizuar?

23 PË. Po. Unë e kam shikuar atë, më kujtohet që e kam parë z.
24 Thaçi, kam shikuar sepse ishte zëdhënësi, ishte i pastër, i
25 veshur mirë, dukej më perëndimor se të tjerët. Nuk dukej se

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 54

1 kishte qenë në pyll duke luftuar një vit ose dy vite rresht.

2 De ishte e qartë se nuk ishte përgjegjës aty, nuk komandonte
3 aty.

4 PY. Faleminderit, Gjeneral.

5 PË. Ai ishte aty. Ai ishte njëri prej personave që njihja më
6 mirë. Unë nuk isha takuar më parë me Çekun, por nuk mund të
7 merresha me këtë çështje përmes Thaçit. Nuk ishte ai
8 përgjegjës aty.

9 PY. Faleminderit, Gjeneral.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, shoh që është, sa
11 është ora.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
13 pushimin e drekës tani, Gjeneral. Do të marrim -- dhe pastaj
14 do të kthehemi për vazhdimin e dëshmisë suaj.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pushimi i
17 drekës deri në orën 14.30.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit. A mund të bëjmë
19 diçka me mikrofonin?

20 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
22 ndërpritet. A keni diçka për të thënë në procesverbal?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Desha t'ju jap një përditësim për
24 kohën që më nevojitet për pyetjet e mia. Më kanë ngelur besoj
25 rreth 30, 45 minuta për të përfunduar dhe pastaj --

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
2 që na informuat. Seanca ndërpritet deri në 14.30.

3 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.30

4 --- Seanca rifillon në orën 14.31

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] U përpoqën
6 t'ia rrisin pak volumin tek pajiset dëshmitarit. Ju lutem
7 përpiguni të flisni sa më shumë afër mikrofonit.

8 Ju lutem silleni tani dëshmitarin në sallë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndërkohë që presim për
10 dëshmitarin, bëmë verifikimin dhe mund t'ju themi që Shënimi
11 Përgatitor 1 mund të jetë publik si dokument, ndërsa për
12 deklaratën e dëshmitar do të dorëzojmë një version të
13 redaktuar publik.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur do ta
15 dorëzoni këtë material?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Deri të mërkurën.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Faleminderit.

19 Ju lutem, Sekretar i seancës, riklasifikoheni dokumentin
20 si publik.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Materiali
22 1D00431 do të klasifikohet si material publik. Faleminderit.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A më dëgjoni
25 më mirë?

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 56

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Po. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
3 vazhdojmë me dëshminë tuaj. Fjalën e ka ende z. Misetic.
4 Dëgjojeni me vëmendje.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Dhe mirë se u kthyet, Gjeneral.

7 PË. Faleminderit.

8 PY. Po diskutonim takimin me komandantët e zonave që keni
9 pasur në shtator të 1999. A e dini ju që Gjenerali Mike
10 Jackson ka shkruar një libër me kujtimet e veta?

11 PË. Po, kam dijeni për këtë.

12 PY. E keni lexuar librin?

13 PË. Në fakt, jo, nuk e kam lexuar.

14 PY. Në rregull.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës të
16 vendosë në ekran provën materiale 1D214.

17 PY. Gjeneral do ju tregojmë një pjesë të librit të Gjeneralit
18 Jackson që flet për takimin që keni pas ju me komandantët e
19 zonave dhe më pas do ju pyes nëse përputhet kjo dhe me
20 kujtesën tuaj dhe të bëni komente nëse keni?

21 PË. Në rregull.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 2 ju lutem.

23 Paragrafi i parë në krye, zmadhojeni pak më shumë që ta lexojë
24 dhe Gjenerali.

25 PY. Ai thotë:

1 "Fola me Wes Clark, që sugjeroi që duhet të shkojë ai me
2 avion në mënyrë që të bëhej pjesë e negociatave. Për mua kjo
3 ishte diçka me kuptim. Më në fund unë fjeta në orën 6.30 dhe u
4 zgjova në orën 10.00. Wes arrin në orën 2.00 të pasdites dhe
5 delegacioni i UÇK-së ishte me ne pas 45 minutash. Wes ishte në
6 tipin e tij të zakonshëm dhe me besim brenda në dhomë, po
7 tregonte histori për përvojat e tij në Vietnam dhe komandantët
8 e zonave të UÇK-së po e ndiqnin me vëmendje çdo fjalë të
9 tijën. Më pas ai bëri një fjalim të fortë kundër serbëve, i
10 cili i kishte acaruar diplomatët po ta dëgjonin çfarë tha ai.
11 U bë e qartë që dallimet mes dy palëve ishin ngushtuar. E
12 zgjidhëm çështjen e emblemës, u pajtuam që të kishte një formë
13 të vetë Kosovës në fakt. Ajo që na vinte në mendje ishte që
14 politikani ynë i ri kanadez Wendy Gilmor -- këshilltari
15 kanadez i ri Wendy Gilmor doli me një formulim për aspektet që
16 kishin mbetur, qasja për armët, e cila ishte e kënaqshme për
17 të gjitha palët. Dolën emra të rinj. Edhe a do të ishim të
18 përgatitur ne organizatën e Kosovës, gardës së Kosovës?
19 Heshtje.

20 "Çeku tha: 'Po shumë, shumë ushtarake kjo' dhe filloi dhe
21 të qeshte.

22 "'Këtë duhet ta kisha thënë unë', bëri shaka Wes. Dhe më
23 në fund vendosëm që ta quanim Trupat për Mbrojtjen e Kosovës
24 këtë gardën fillimisht."

25 Keni ndonjë koment lidhur me rrëfimin e Gjeneralit

1 Jackson?

2 PË. Jo, për mua është gjithçka në rregull.

3 PY. Do të shohim diçka tjetër që keni thënë në deklaratën
4 tuaj, në paragrafin 33 të deklaratës tuaj.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Ta heqim dokumentin nga ekrani dhe
6 të nxjerrim sërish në ekran provën 1D430. Të shohim paragrafin
7 33.

8 PY. Këtu po flisni për dhunën pas luftës në këtë paragraf dhe
9 thoni bazuar në informatat që kishim marrë prej terrenit ia
10 atribuova këtë dhunë në verën e 1999 "shumë faktorëve,
11 përfshirë urrejtjen, larjen e hesapeve, shpagimin,
12 gjakmarrjen, bandat kriminale edhe krime zilie dhe prej
13 oportunistëve".

14 Ju thoni se:

15 "Shumë prej këtij kaosi ishte i pashmangshëm për shkak të
16 shtypjes që kishin pësuar për një dekadë e gjysëm prej
17 serbëve."

18 Tani dua të shohim një video.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim në ekran videon 1D00076.
20 Do të shohim filmimin dhe do të më thoni nëse përputhet kjo me
21 këtë që keni thënë në paragrafin 33.

22 PY. Është një video ku flet Ken Bacon, zëdhënësi i
23 Pentagonit, është një deklaratë për shtyp në Pentagon më 5
24 qershor, përpara futjes së forcave të NATO-s në Kosovë dhe
25 përpara Rezolutës 1244.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim videon.

2 [Luhet videoincizimi]

3 "... nuk mendoj se Kosova do të jetë shumë vend i mirë
4 për serbët kur të hyjë NATO dhe nuk besoj se serbët do të duan
5 të qëndrojnë atje. Besojnë se do duan të kthehen në Serbi. Ne
6 nuk e dimë sa e madhe është pakica serbe atje. Mendoj se janë
7 rreth 100.000 persona pak a shumë. Por në momentin që do të
8 vërshojnë në vendin e tyre shqiptarët e Kosovës supozimi ynë
9 është që shumë serbë me të ngjarë do të kthehen në Serbi.

10 "Duket sikur po inkurajoni serbët që jetojnë në Kosovë të
11 largohen?

12 "Absolutisht jo. Po ju them çfarë mendojmë ne se do të
13 ndodhë, çfarë parashikojmë ne se do të ndodhë."

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Pra, z. Bacon thotë se Pentagoni parashikon që serbët të
16 largohen nga Kosova kur të hyjnë forcat e NATO-s. A mund të na
17 thoni pse ekzistonte ky parashikim, parashtrim mendohej që do
18 largoheshin serbët?

19 PË. Po Ken Bacon nuk po fliste në emrin tim. Asnjëherë nuk
20 jam fokusuar në këtë pjesë. Unë doja thjesht që të kishte rend
21 publik në Kosovë. Por në situata të tilla në qoftë se nuk ke
22 polici që të flasë gjuhën e popullit dhe të trajtojë situatën,
23 sigurisht që situata del jashtë kontrollit.

24 Përvoja ime ka filluar me ndërhyrjen në Haiti në 1994 dhe
25 republikanët në Kongres atëherë ishin të ndarë aso kohe nëse

1 duhet të përfshihej ushtria amerikane. Dhe më thanë, "Mund ta
2 bëni po ushtarët tanë nuk janë policë". Prandaj ishim shumë
3 të kujdesshëm me rregulloret që mos të përfshihej ushtria në
4 detyra policore. Dhe zgjati një ditë dhe zgjati vetëm një ditë
5 trupat ishin atje, pati dhunë mes haitasve edhe menjëherë
6 shtypi foli dhe tha, "Si ka mundësi që forcat ushtarake
7 amerikane po e shohin dhunën dhe nuk bëjnë asgjë". Kështu që
8 na u desh që të rishkruanim rregulloren menjëherë po atë
9 pasdite dhe t'ia çonim drejtuesve tanë.

10 Kështu ndodhë gjithmonë në rrethana të tilla, duhet ta
11 kuptojë dhe Trupi Gjykses këtë gjë.

12 Dhe do tua shpjegojë disi ndryshe. Në Afganistan, kur
13 hynë forcat amerikane, forcat e NATO-s në Afganistan, nuk e
14 flisnim gjuhën. Gjithmonë kërkonim përkthyes po s'kishim as
15 përkthyes gjithmonë. Na vinin persona të ndryshëm na thonin
16 "Po më vodhën biçikletën", po ne nuk mund t'i trajtonim këto
17 vepra penale. Dhe Afganistani na tregoi se forcat amerikane
18 ishin përfshirë në zënka madje dhe mes familjeve në
19 Afganistan.

20 Prandaj kur forcat e NATO-s hynë në Kosovë, unë dhashë
21 udhëzime shumë të qarta Mike Jackson, i thashë që duhet të
22 sigurohemi që të ketë paqe të mos lejojmë spastrim etnik.
23 Dislokuam forcat, bëmë çfarë kishim në dorë për të zvogëluar
24 aktet e dhunës. Por, keni parasysh këtu flitet për jetë a
25 vdekje. Personave që ju kanë marrë sendet personale që kishin

1 frikë për jetën e tyre. Që kishin parë t'u digjeshin shtëpitë
2 nga fqinjët, t'u plaçkiteshin shtëpitë nga fqinjët. Nuk e
3 imagjinoni dot dhimbjen që kishin këta njerëz.

4 As ne madje nuk e kemi kuptuar siç duhet, por kur u
5 ktheva me Solanon më pas, mbase ka qenë java e tretë e
6 korrikut. Shkuam në Prishtinë. Shkuam të vizitonim zyrat e
7 kombeve të bashkuara atje dhe ndaluan tek KFOR-i rrugës. Me
8 qindra, mijëra persona dolën në rrugë dhe na kontaktuan. Kjo
9 ishte mirënjohje nga ana e tyre për shkak se larguam shtypjen
10 prej serbëve. Pra, ishin ndjenja shumë të forta dhe është e
11 pashmangshme që të kishte dhe akte të tilla sporadike dhune.
12 PY. Në rregull. Faleminderit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim në ekran provën
14 materiale 1D96.

15 PY. Përpara se të shohim videon, Gjeneral, në paragrafin 34
16 të deklaratës, thoni se, në verën dhe fillimin e vjeshtës
17 1999, nuk morët asnjë informacion informativ apo ndonjë lloj
18 informate që udhëheqja e UÇK-së synonte të shënjestronte
19 serbët apo pakicat, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Po ashtu thoni se nuk besoni se udhëheqja e UÇK-së ishte
22 angazhuar në përpjekje të koordinuara për të shënjestruar dhe
23 sulmuar serbët dhe minoritetet?

24 PË. Po.

25 PY. Ju thoni që z. Thaçi nuk kishte ndonjë motiv për t'u

1 përfshirë në akte të tilla?

2 PË. Po.

3 PY. Në rregull.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim këtë filmim tuajin në PBS
5 lajmet në 1 korrik 1999, gati pothuajse përafërsisht tri javë
6 pas futjes së NATO-s në Kosovë. Shohim videon dhe më pas do
7 t'ju bëj disa pyetje.

8 [Luhet videoincizimi]

9 "Margaret Warner ka intervistë me Gjeneralin amerikan
10 Wesley Clark, komandant i forcave aleate të NATO-s. Ajo foli
11 me atë në këtë mbrëmje.

12 "Mirë se erdhët, Gjeneral.

13 "Faleminderit, Margaret.

14 "Dua t'ju flas për misionin e KFOR-it në Kosovë.
15 Sekretarja e Shtetit Albright tha dje se kur ishte në OKB,
16 populli i Kosovës nuk jam i sigurtë. Kështu?

17 "Mendoj, se fillimisht duhet të kuptojmë se çfarë po
18 ndodh atje. Po kthehen me qindra, mijëra persona në Kosovë. Në
19 atë shtet kanë ndodhur gjëra të tmerrshme. Kështu që sigurisht
20 që njerëzit po përjetojnë ndjenja të ndryshme. Ka ende serbë
21 atje, disa prej të cilëve mund të kenë qenë pjesë e sulmeve,
22 të tjerët që janë thjesht të frikësuar se do t'i fajësojnë për
23 shkak të etnisë tyre. Ka po ashtu egjiptianë që po
24 diskriminohen. Pra, po njerëzit në mënyrë legjitime po
25 përpiqen po ashtu të marrin pronat e tyre. Ka akte

1 hakmarrjeje, po lahen hesapet. Nuk e di me siguri, po janë
2 momente shumë të vështira. Trupat tona janë atje, ne po bëjmë
3 ç'të mundim, ne nuk jemi polici.

4 "Mendoni se nëse serbët largohen dhe nuk kthehen, a nuk
5 cenon kjo besueshmërinë e NATO-s sa i takon përfshirjes në një
6 luftë, a nuk cenon kjo idealin multietnik?

7 "Duhet të jemi, të krahasojmë idealet me realitetin. Ne
8 nuk e dimë sa e shtrirë është pjesëmarrja e popullatës serbe
9 në krimet që kanë ndodhur atje, në masakrat që kanë ndodhur
10 atje. Dhe mbase shumë prej këtyre personave i kanë dëmtuar
11 pronat e fqinjëve, kanë marrë pjesë në akte dhune, banditësh
12 dhe nuk janë sjellë mirë gjatë kohës që po kryhej spastrimi
13 etnik. Pra, thjesht nuk e dimë. Kështu që mbase disa prej
14 personave që po largohen vërtetë mendojnë që janë shënjestër
15 për drejtësinë ndërkombëtare si dhe mund të jenë objekt i
16 akteve hakmarrëse prej shqiptarëve. Po ua thashë të mos e
17 përgjithësojmë. Dhe udhëheqja e UÇK-së po ashtu ka kërkuar për
18 një Kosovë multietnike.

19 "E kanë me të vërtetë, janë të singertë?

20 "Po, mendoj se janë të singertë në thirrjet e tyre."

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Gjeneral, më 1 korrik 1999, ju keni menduar që udhëheqja
23 e UÇK-së ka qenë e singertë dhe e çiltër kur ka kërkuar për
24 një shoqëri multietnike. Dhe ju e sqaruat në seancën
25 përgatitore dhe thatë që këtu nënkuptoja dhe z. Thaçi.

1 Pyetja ime është kjo: A keni marrë ndonjëherë ndonjë
2 informacion tjetër, ndonjë informacion informativ të
3 mëtutjeshëm që ju të ndryshonit mendimin sa i takon qëndrimin
4 të UÇK-së, z. Thaçi për një Kosovë multietnike.
5 PË. Jo, nuk kam marrë asnjë informacion që kundërshton atë që
6 kam thënë në këtë video.

7 Po më lejoni një çast t'i shpjegoj Trupit Gjykues, t'ju
8 jap një shembull se çfarë ndjenin njerëzit asokohe.

9 Dikund nga mesi i prillit, pilotët tanë A-10 filluan --
10 po fluturonin mbi Kosovë dhe panë një rresht me traktorë afër
11 Drenicës që ishin të mbushur me persona. Pra, avionët ishin
12 shumë lart dhe po shikonin me dylbi dhe panë traktorë me
13 persona që ndalonin në disa shtëpi dhe u vendosnin flakën
14 këtyre shtëpive. Dhe filluan të vrisnin mendjen, çfarë po
15 ndodhë? Ky piloti atëherë filloi të sulmonte traktorët sepse
16 mendoj se këta ishin serbë që po sulmonin shqiptarët, goditi,
17 pra, avioni goditi traktorët.

18 Të nesërmen Milosheviqi i kërkoi shtypit ndërkombëtar të
19 shikonte vendngjarjen dhe, në fakt, u kuptua që këta ishin
20 thjesht njerëz të thjeshtë që i vranë forcat tona ajrore. Ne
21 kryem një hetim. Pilotët u lënduan shumë kur u ballafaquan me
22 faktet.

23 Dhe shumë vite më pas, kur udhëtoj, njerëzit vijnë më
24 takojnë, shqiptarët më ndalojnë në rrugë dhe duan të flasim me
25 mua. Para dy apo tri vitesh takova dikë në aeroport që më tha,

1 "Kam qenë dhe unë në një nga ato traktorë". Unë ju përgjigja
2 dhe i thashë, "Ke qenë në këtë traktorë në Drenicë kur ju
3 sulmoi A-10?" Ai ju përgjigj, "Po". Dhe unë e pyeta, "Po pse
4 po u vendosnit flakën shtëpive?" Dhe ai u përgjigj, "Ne po i
5 vendosnim flakën shtëpive se e dinim që do vinin t'i merrnin
6 serbët dhe ne preferuam t'i digjnim sesa t'ua linim serbëve".
7 Pra, ky ishte shpjegimi.

8 Pra, kjo tregon sesa të forta ishin ndjenjat, sa të
9 zemëruar ishin këta persona, sa të mllëfosur, sa të frikësuar.
10 Pra, duhet të kuptoni si ka qenë situata dhe se çfarë ndjenin
11 personat në terren në Kosovë, të trembur, po të vendosur po
12 ashtu, të gatshëm të digjnin pronat e tyre e të mos ua linin
13 në dorë serbëve.

14 Pra, është e vështirë, është e vështirë të thuash
15 personave "Qetësohuni tani. Do zgjidhet çdo gjë. Do ta marri
16 policia situatën nën kontroll". S'kishte polici.

17 PY. Faleminderit. Dua t'i shpjegoni Trupit Gjykues si i
18 merrnit informacionet lidhur me ato çka po ndodhnin në Kosovë
19 dhe çfarë informacionesh merrnit. Do të doja t'i merrnim hap
20 pas hapi. Fillimisht, lexonit raporte dhe për ngjarjet që
21 ndodhnin në terren, çdo lloj raporti?

22 PË. Unë i merrja të gjitha raportet e mundshme. Lexoja sa të
23 mundesha. Njerëzit e dinin që isha i interesuar për Kosovën
24 edhe merrja shumë informacione.

25 PY. Në verën e 1998-s?

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 66

1 PË. Filloi në verën e 1998-s. Lexoja çdo raport, ngjarjeje që
2 ndodhte. Çdo raport që vinte për incidentet. Deri në verën e
3 1999-s.

4 PY. Faleminderit. A merrnit informacione, a merrnit raporte
5 informative nga forcat e KFOR-it?

6 PË. Po.

7 PY. Po përpara se të shkonit në Kosovë a morët ndonjë
8 informim paraprak?

9 PË. Po.

10 PY. Kur shkuat në Kosovë a u informoi personalisht Gjenerali
11 Jackson?

12 PË. Po.

13 PY. E konsideronit veten tërësisht të informuar lidhur me atë
14 që po ndodhte në terren?

15 PË. Mendoj se isha aq i informuar sa ç'duhej sepse unë isha
16 komandant strategjik. Mike ishte në terren, ai ishte
17 komandanti i operacionales, operativ. Ai ishte çdo ditë, çdo
18 orë pranë realitetit, jam i bindur se ai dinte më shumë seç
19 dija unë.

20 PY. Do të flasim për një dokument.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po për shkak të kufizimeve të
22 këtij dokumenti do ju lutesha që të kalonim në seancë private.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
24 seancë private.

25 [Seancë private]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 67

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 68

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 69

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 70

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6 [Seancë e hapur]

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 jemi në seancë publike.

9 Z. MISETIC: [Përkthim]

10 PY. Gjenerali Clark, në paragrafin 52 të deklaratës tuaj, ju
11 thoni se nuk besoni që do ishte e drejtë që sjelljen e keqe të
12 të tjerëve t'ia atribuonin z. Thaçi. A mund të na thoni se
13 çfarë keni dashur të thoni me më tepër detaje në këtë
14 deklaratë tuajën?

15 PË. Unë nuk mendoj që z. Thaçi ka pasur kontroll mbi njerëzit
16 që i kanë bërë akte të tilla. Së pari, nuk është e qartë që
17 dhuna ishte kryer nga UÇK-ja. Edhe po të ishte kështu ajo
18 ishte realizuar nga individë të caktuar. Unë kam folur me Mike
19 Jackson lidhur me këtë dhe, sigurisht, domethënë, që ai ka
20 folur me komandantët e tyre dhe ata kanë qenë në kontakte me
21 personat e UÇK-së që lidheshin me zona të caktuara
22 përgjegjësie. Unë nuk besoj që ka qenë UÇK-ja. Po edhe po të
23 këtë qenë UÇK-ja nuk kishte askush kontroll, nuk kishte
24 mekanizëm kontrolli mbi atë çfarë ndodhte në terren. Nuk është
25 se funksionon ndonjë gjë e tillë që ti jepje urdhër dhe pastaj

1 prisje që njerëzit ta zbatonin këtë urdhër. Ishte më tepër një
2 rezistencë, njerëzit ishin në rezistencë për shkak se donin që
3 të shpëtonin jetët e tyre.

4 Në qoftë se do të shikojmë histori të ngjashme me pasoja
5 të ngjashme si kjo, në fakt, ka një volum të konsiderueshëm
6 dokumentesh që lidhen me Revolucionin amerikan, po të shikosh
7 atë çfarë ka ndodhur në revolucionin amerikan, ka të gjitha
8 llojet e mundshme të veprimeve të ngjashme që janë akte
9 pasioni kundër britanikëve në këtë rast nga amerikanët,
10 domethënë, në qoftë se janë gjetur në një situatë të ngjashme.
11 Asgjë nuk është se ka ndodhur në mënyrë të organizuar, thjesht
12 është një mënyrë reagimi i personave të caktuar.

13 Unë personalisht nuk kam marrë asnjëherë asnjë
14 informacion të tillë. Sigurisht që ne donim që ta ndalonim
15 këtë situatë. Më besoni mua se në qoftë se ne do të kishim
16 informacion që këto ishin akte të organizuara nga UÇK-ja,
17 sigurisht që do ishim siguruar që të punonim kundër këtyre
18 veprimeve. Po ne këtë informacion nuk e kishim. UÇK-ja e
19 kuptonte qartë se ata nuk do të merrnin atë që morën në fakt,
20 që ishte heqja e forcave serbe po të mos ishte për NATO-n. Dhe
21 ata nuk kishin asnjë mjet që të mbronin veten kundër
22 presioneve të forcave serbe. Pra, ishte një rast shumë i qartë
23 që motivi për ta ishte që të dëgjonte se çfarë thoshte KFOR-i
24 dhe të bënin atë çfarë i kërkonte KFOR-i, domethënë, kjo ishte
25 situata.

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 73

1 PY. Faleminderit, Gjeneral, kaq pyetje kisha për ju.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Dixon, fjala për ju.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam vetëm disa
5 pyetje për këtë dëshmitar.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

7 Mund të vazhdoni me pyetjet, z. Dixon.

8 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

9 Z. DIXON: [Përkthim]

10 PY. Faleminderit, Gjeneral Clark. Unë quhem Rodney Dixon. Dhe
11 jam përfaqësuesi ligjor i z. Kadri Veseli. Kam disa pyetje
12 shitesë për ju. Shpresoj që të më dëgjoni mirë.

13 PË. Kur flisni në drejtim të mikrofonit ju dëgjoj goxha më
14 mirë.

15 PY. Në rregull. Do të përpiqem të flas më pranë mikrofonit.

16 PË. Në rregull.

17 PY. Gjenerali Clark, përpara pak çastesh ju bënë disa pyetje
18 lidhur me valën e dhunës në verën e vitit 1999 dhe ju thatë se
19 cilat ishin shkaqet e kësaj dhune. Në një intervistë të
20 mëtejshme me Avokatin e z. Thaçi keni dhënë informacion i cila
21 është dhënë në atë çfarë e quajmë Shënimi Përgatitor numër 2.

22 A ju kujtohet Shënimi Përgatitor numër 2 që ju është
23 lexuar juve dhe që ju thatë që ju është lexuar?

24 PË. Çfarë thuhet në atë shënimin përgatitor? Ma lexoni dhe
25 pastaj ju them.

1 PY. Në rregull. Do jua lexoj atë çfarë i keni thënë avokatit
2 dhe pastaj do ju pyes në qoftë se kjo është deklarata juaj apo
3 jo.

4 Ju thatë që:

5 "... nuk bëhej fjalë vetëm thjesht për hakmarrje ..."

6 Z. DIXON: [Përkthim] Për ata që më ndjekin në Gjykatë
7 bëhet fjalë për paragrafin 2.

8 PY. "Popullata shqiptare zotëronte pjesën dërrmuese të tokës
9 dhe ekzistonte një element ndërmjet serbëve që 'ju keni diçka
10 që ne donim ta kishim në vendin tuaj' duke filluar pas vdekjes
11 së Titos, nacionalizmi serb kishte ardhur në përshkallëzim për
12 15 vite duke u rritur, përfshirë këtu dhe pritshmërinë që
13 ishin një shoqëri eprorë ndaj shqiptarëve dhe po i shtynin
14 shqiptarët jashtë civilizimit të vet dhe qeverisjes së vet.
15 Ishte spastrim etnik në të gjithë nivelet e mundshme, jo në
16 nivelin e qeverisë vetëm por gjithashtu edhe në nivelin e
17 komshinjve me njëri-tjetrin. Kur NATO erdhi me zbatimin e një
18 zgjidhje të barabartë, shumë njerëz të cilët ishin përfshirë
19 në spastrimin etnik, si rezultat ishte më se e natyrshme që
20 këta persona të donin që të largoheshin prej aty ku ishin."

21 A është ky pasqyrim i asaj çfarë keni thënë Mbrojtjes së
22 z. Thaçi, Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Kur thoni këtu që "shumë persona që ishin të përfshirë në
25 spastrim etnik për pasojë më vonë donin që të zhvendoseshin

1 prej aty", e keni fjalën për një pjesë të popullsisë serbe në
2 Kosovë që dëshironin që të largoheshin prej Kosove?

3 PË. Po, kjo ishte pritshmëria ime.

4 PY. Po në realitet a jeni në dijeni në qoftë se një gjë e
5 tillë ka ndodhur apo jo?

6 PË. Ne nuk kemi pasur asnjëherë statistika të sakta për
7 popullsinë sepse statistikat e popullsisë ishin gjithmonë të
8 motivuara politikisht. Ne nuk e dinim asnjëherë me siguri nuk
9 mund t'ju themi as sot dhe as atëherë në qoftë se janë
10 zhvendosur 200.000 serbë apo 100.000 serb. Ndërkohë që në
11 censusin e fundit, në regjistrimin e fundit të popullsisë që
12 është bërë diku nga vitet 1990, në mos gabohem. Por ajo çfarë
13 mund të them është që Milosheviqi dhe njerëzit e vet i kishin
14 zmadhuar numrat e regjistrimit të popullsisë në mënyrë të
15 tillë që t'i shërbenin qëndrimeve të tyre.

16 PY. A keni qenë në dijeni që, sikurse e keni thënë këtu, ka
17 pasur dhe mosmarrëveshje të lidhura me tokën në territorin e
18 Kosovës?

19 PË. Në përgjithësi po. Nuk është se di konkretisht se çfarë
20 problemesh, çfarë mosmarrëveshjes ka pasur. Por ajo çfarë di
21 unë është që ka pasur ca mosmarrëveshje ose inate ndërmjet
22 familjeve që banonin në të njëjtat fshatra ose zhvatje të
23 tokës nga njëri-tjetri dhe e di që kanë ekzistuar probleme të
24 tilla. E dimë dhe kemi marrë raporte që ka pasur serbë dhe që
25 kanë përfituar nga situatat, kanë vjedhë prona, e kështu me

1 radhë.

2 Sigurisht në përgjithësi -- megjithatë do kthehem pas për
3 një çast dhe do ju jap një panoramë pak më të përgjithshme.

4 Unë kam bërë shumë punë në Evropën lindore, kam punuar në
5 këto vende për shumë e shumë vite. Kam folur shumë mirë
6 rusishten dhe kam marrë pjesë në kurse të ndryshme për gjuhën
7 ruse në *West Point*. Kam shkuar në Bashkimin Sovjetik në vitin
8 1964, kam qëndruar atje dhjetë ditë për të udhëtuar rreth e
9 qark në vend. Po ashtu kam qenë pjesë e bisedave të Shtabit të
10 Përgjithshëm ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Rusisë. Kam
11 shkuar dhe kam biseduar, kam marrë pjesë në takime të ndryshme
12 J5 në vitet 1990. Kam vizituar Moskën. Njihja gjeneralë nga
13 Moska, kam vizituar, kam trajnuar njerëz në Moskë, kam parë
14 situatën e përgjithshme. Dhe gjithashtu kam qenë në Gjermani
15 gjatë luftës së ftohtë, domethënë, me fjalë të tjera e kam
16 bërë siç duhet detyrat e mia.

17 Kishte një pansllavizëm që ka dalë në pah në shekullin
18 XIX që unë nuk e kisha parë asnjëherë në Evropën Lindore. Dhe
19 mbaj mend që kam diskutuar me një ministër të mbrojtjes në
20 Rumani në 1998-n dhe e kam pyetur atë, "A dëshironi ju të
21 bëheni anëtarë të NATO-s?" në përgjigje ai më tha, "Sigurisht
22 që po". Unë e pyeta më tej "Pse? Ka ndonjë gjë të bëjë me
23 Rusinë kjo?" Dhe përgjigja që mora prej tij ishte "Sigurisht
24 që po". E pyetja më tej a mund të më përshkruante disa
25 incidente në mënyrë të tillë që të mund t'ia shpjegoja

1 situatën në Uashington. Ai më tha "Sigurisht". Dhe në mendjen
2 time ai do më thoshte që ambasadori rus kishte ushtruar trysni
3 në një konferencë dhe kishte qenë jo i sjellshëm me të. Por në
4 vend të kësaj ai më tha, "Në 1978-n, ne i lejuam forcat ruse
5 që të futeshin përmes një rruge që më vonë u bë pjesë e
6 territorit jugosllav dhe ata u kthyen dhe na vodhën provincën
7 e Besarabisë ne".

8 Kur kam qenë në Bullgari si komandant i NATO-s, ministrja
9 e punëve të jashtme më tha që, "Sot Rusia është e dobët por do
10 vijë një ditë që Rusia do fuqizohet dhe përpara kësaj kohe
11 Bullgaria duhet të jetë në NATO". Ti mund të pyesësh "Po pse i
12 thoni të gjitha këto? Pse ishin të gjitha këto zhvillimet?".
13 Sot e kësaj dite ne e shikojmë të njëjta manifestime të
14 konfliktit ndërmjet Rosisë dhe Ukrainës.

15 Nuk dua të jap leksion këtu, por thjesht dua që t'ju
16 shpjegoj që ekziston një lloj ndjesie epërsie që vjen nga
17 Moska. Dhe në qoftë se ti nuk je, për shembull, rus, shtetas
18 rus apo me prejardhje ruse i takon që ti nuk ke vlerë ose nuk
19 je sllav, me prejardhje sllave i takon që ti ke pak më tepër,
20 ke më shumë vlerë sesa, për shembull, kosovarët ose shqiptarët
21 e Kosovës. Domethënë, ideja është që ekziston e njëjta ndjesi
22 epërsie ndërmjet serbëve në raport me shqiptarët e Kosovës.
23 PY. Faleminderit për shpjegimin e hollësishëm. Dua t'ju pyes
24 me një tjetër çështje që ju e keni identifikuar në shënimin
25 përgatitor në paragrafët 6, 7 dhe 8. Nuk është e nevojshme ta

1 shikoni, por do jua lexoj unë. Do ju lexoj përmbajtjen pastaj
2 do ju bëj pyetje në qoftë se keni thënë vërtetë kështu. Kjo ka
3 të bëjë me pyetjet që ju janë bërë lidhur me informacionin,
4 domethënë, informacionin e papërpunuar që ju keni pasur në
5 dispozicion gjatë kohës së luftës në vitin 1998 dhe 1999 dhe
6 ku ju thatë që mendonit që kishit mangësi në njohuritë tuaja.

7 "Kur u pyetët lidhur me informacionin e marrë, ju
8 deklaruat që ju keni lexuar çdo raport që ishte i shkruar.
9 Thatë që keni marrë informacione, mesazhe çdo mëngjes, kemi
10 marrë gjithashtu edhe informacione që kishin të bënin me
11 raportet informative ose rastet e incidenteve. Dhe thatë që
12 aktualisht ose sot nuk mund të kujtoni asnjë incident, por që
13 keni qenë plotësisht i informuar rreth të gjitha incidenteve
14 në atë kohë.

15 "Përpara se ju të shkonit në Kosovë, ju informoi
16 plotësisht për situatën. Por edhe kur ishit në Kosovë, ju
17 informoheshit lidhur me përshtypjen e Gjeneralit Jackson e
18 megjithëse ju nuk besoni që Gjenerali Jackson kishte më shumë
19 informacion sesa kishit ju vetë. Thoni gjithashtu që, ishit
20 informuar përmes instrumenteve të ndryshme si, për shembull,
21 në prezantime në *Power Point*, po gjithashtu edhe në raporte
22 për incidentet që i njihnit, vendndodhjet, emrat e fshatrave
23 dhe aktorët e përfshirë. Pra, ishte një përpjekje e
24 vazhdueshme, e përditshme për ju për të pasur një panoramë sa
25 më qartë të mundur lidhur me Kosovën. Kur ishit në terren, ju

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 79

1 i keni kërkuar Gjeneralit Jackson t'ju thoshte përshtypjet dhe
2 opinionet e veta ,po gjithashtu edhe jeni informuar prej
3 skuadrës së tij paraprakisht.”

4 Më tej ju vazhdoni dhe thoni që:

5 “ ... ishte e pamundur për UÇK-në të kishte një zinxhir
6 komandues funksional, një hierarki të plotë nga lart poshtë
7 dhe, po të ishte një gjë e tillë ne, si NATO dhe Shtetet e
8 Bashkuara, do e kishim pasur këtë informacion.”

9 A pajtoheni me këtë, a e keni thënë këtë gjë, Dëshmitar?
10 PË. Po.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë, është një pyetje e
12 përbërë dhe të paktën fjalë e dytë në paragrafin 7 bie ndesh
13 me faqen 58 të transkriptit në kohë reale.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Këtë ka thënë në dëshmi dëshmitari.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Dua të sqaroj diçka. Dua të them
18 që unë dija, nuk kam dashur të jap përshtypjen dhe të them që
19 unë dija më shumë sesa dinte Jackson. Por kam dashur të them
20 që unë lexoja dhe isha i informuar në shumë burime, përmes
21 shumë burimeve lidhur me të gjitha zhvillimet në Kosovë, por
22 gjithashtu edhe përmbledhjet informative.

23 Z. DIXON: [Përkthim]

24 PY. Në rregull. Pyetja ime ishte: Në qoftë se ajo çfarë u
25 lexova unë përpara një çasti ishin burimet e informacionit që

1 i keni marrë dhe në qoftë se këto informacione ju i keni marrë
2 në të përditshmen tuaj

3 PË. Po, kam pasur burime të shumta informacioni. Kisha
4 informacion nga burimet informative, kisha informacion
5 informativ në nivelin *top secret*, kisha informacion lidhur me
6 bisedat që qarkullonin, raportet e incidenteve, kabllogramet
7 informatike. Kisha gjithashtu informacion që më ishte
8 transmetuar përmes Bernard Kouchner apo përmes Kombeve të
9 Bashkuara e kështu me radhë.

10 PY. Dhe ky informacion që ju keni përshkruar në detaje, këtu
11 përfshihet dhe informacioni që kishte të bënte me UÇK-në apo
12 jo?

13 PË. Sigurisht që po. Në qoftë se do ekzistonte një
14 informacion i tillë, në qoftë se do ishte e organizuar UÇK-ja,
15 sigurisht që ne do e kishim pasur një informacion të tillë.

16 PY. Po informacioni i përfshirë në dokumente të prodhuara nga
17 UÇK-ja, juve a e kishit këtë informacion?

18 PË. Besoj se po. Nuk më kujtohen dokumente të UÇK-së, por
19 besoj se po.

20 PY. Po burimet që keni pasur, në qoftë se do të ekzistonte
21 një informacioni i tillë a do jua kishin shpjeguar, do jua
22 kishin përmbledhur këtë informacion, do ta kishit pasur një
23 informacion të tillë në dispozicion?

24 PË. Sigurisht që po.

25 PY. Kam një çështje të fundit, Gjeneral, përpara sesa të

1 përfundoj me pyetjet e mia, kjo pyetje lidhet me atë çfarë
2 thatë në dëshminë tuaj më herët, se ju nuk keni pasur vëzhgues
3 të cilët mund të jepnin informacion sa i takon sulmeve, kjo ka
4 ndodhur gjatë bombardimeve të NATO-s në mars të 1999, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Ju nuk keni pasur ndonjë informacion lidhur me pozicionet
7 serbe në atë kohë nga UÇK-ja, a është e saktë kjo?

8 PË. Po.

9 PY. Kur ju thoni se personat e shërbimit informativ tuajit e
10 kishin identifikuar një qendër serbe ose shtab serb, një
11 godinë serbe, siç e përmendët juve më herët gjatë dëshmisë
12 tuaj. Ky është informacion që e kanë identifikuar personat
13 tuaj ose shërbimi juaj inteligjent. Nuk është se sa
14 identifikuar UÇK-ja, apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera për ju.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
19 vazhdoni, z. Roberts.

20 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

21 Z. ELLIS: [Përkthim]

22 PY. Unë quhem Aidan Ellis, përfaqësoj z. Jakup Krasniqi. Do
23 të përpiqem që të flas sa më pranë mikrofonit për të më
24 dëgjuar plotësisht.

25 PË. Ju dëgjoj shumë mirë.

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 82

1 PY. Do ju bëj disa pyetje që janë të mbështetura në atë çfarë
2 i dhatë si përgjigje pyetjeve të Mbrojtjes së z. Thaçi.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Për këtë do i kërkoj Sekretarit të
4 paraqesë në ekran dokumentin 1D00430. Më konkretisht dëshiroj
5 të paraqitet paragrafi 26 në faqen DHT12552.

6 PY. Do t'jua lexoj, Gjeneral. Në tekst thuhet si më poshtë:

7 "Megjithatë gjatë luftës, unë jepja rregullisht
8 intervista dhe bëja deklaratata duke e lëvdur UÇK-në si një
9 forcë e mirëorganizuar. Në fakt, situata nuk ishte kështu.
10 Audienca e synuar e komenteve të mia ishte Milosheviqi. E dija
11 që ai më dëgjonte dhe dëshiroja që të projektoja këtë lloj
12 force ndaj Milosheviqit në mënyrë që ai të nxitohet për sa i
13 takon dorëzimit të tij. Deklaratat nuk pasqyrojnë vlerësimin e
14 NATO-s lidhur me kapacitetet ushtarake aktuale."

15 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 PY. A është normale, Gjeneral, që në një situatë konflikti të
18 përdoren deklaratat politike për të projektuar pikat e forta
19 kundër dëshmitarëve?

20 PË. Po, është më se normale. Në qoftë se nuk e bën këtë gjë,
21 pra, në qoftë se nuk jep deklaratata publike, ju nuk po përdorni
22 një prej instrumenteve kryesore të përdorura për të
23 komunikuar. Në rastin në fjalë, mbështetur në marrëdhënien që
24 kisha unë me Milosheviqin, unë e dija si drita e diellit që në
25 Beograd ai më dëgjonte, na dëgjonte me vëmendje çfarë po

1 thonim. Natën e bombardimeve të para, gjeneralët e tij i thanë
2 që ata janë goditur dhe goditjet kanë ardhur nga avionë të
3 shumtë ushtarakë të NATO-s dhe më pas mua m'ua desh që të
4 jepja një konferencë për shtyp që ku thoja që kishin ndodhur
5 disa humbje.

6 Dhe kjo ishte një çështje kredibiliteti në fakt me
7 Milosheviqin. Dhe po i thoja, po i thoja qartë mesazhin tim që
8 "Ne po fitojmë, ti po humb". Më lejoni që të ndaj një përvojë
9 timen.

10 Admirali Jim Ellis më herët gjatë fushatës bombarduese ne
11 në fakt hëngrëm darkë bashkë. Ai ishte komandant në Napoli në
12 anën jugore të NATO-s dhe ai ishte një person që ishte nën
13 varësinë time të drejtpërdrejtë. Jackson kishte punuar me
14 Ellis dhe Ellis kishte ngrënë darkë me një gjeneral italian të
15 dalë në pension i cili kishte luftuar në Shqipëri në vitin
16 1942 kur Italia kishte pushtuar Shqipërinë dhe gjenerali
17 italian kishte vazhduar që të shpjegonte gjatë e gjerë sesa
18 luftarakë dhe sa barbari kishin këta shqiptarë dhe një gjë e
19 tillë kishte shkaktuar një frikë të jashtëzakonshme ndërmjet
20 ushtarëve italian në ato luftime. Mendoj që kjo ishte një prej
21 mënyrave për të transmetuar serbëve mesazhin tonë kryesor dhe
22 për këtë arsye, domethënë, situata e pikturuar prej meje ishte
23 një situatë e ngrinte më lart seç ishte UÇK-në.
24 PY. A është e drejtë të thuhet që këto instrumente
25 informacioni në gjendje lufte përfshijnë edhe bërjen e

1 deklaratave duke ekzagjeruar ose duke zmadhuar pikat e forta
2 ushtarake dhe organizimin e strukturave të caktuara?

3 PË. Kjo ndodhë përditë.

4 PY. A mund të përfshihen gjithashtu këtu edhe njohuritë dhe
5 situatat në terren, domethënë, zmadhimi, ekzagjerimi i
6 situatave në terren, pavarësisht që mbase ju nuk keni pasur
7 informacion të plotë në realitet lidhur me atë çfarë po
8 ndodhte?

9 PË. Po, absolutisht e saktë.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ju kërkoja që të paraqisni në
11 ekran dokumentin DHT05384. Është një video dhe transkripti
12 përkatës i videos. Faleminderit. Do kërkoja që videoja të
13 transmetohet në gjysmën e ekranit dhe në gjysmën tjetër të
14 shfaqet transkripti. Në rregull. Ju lutem transmetojeni videon
15 nga sekonda 00:54.

16 [Luhet videoincizimi]

17 "... mendojmë që situata në terren është që, pavarësisht
18 deklaratës së Milosheviqit dhe udhëheqësve ushtarakë, ata në
19 fakt nuk është se kanë përfunduar punë me UÇK-në brenda 7
20 ditëve siç kishin deklaruar dy muaj më përpara. Në fakt ata e
21 kanë bërë UÇK-në edhe më të fortë se çka qenë më përpara. UÇK-
22 ja është një organizatë funksionale ka një komandë dhe
23 kontroll të forcuar, ka shumë vetë në radhët e veta dhe është
24 akoma shumë aktive në të gjithë Kosovën."

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj se kaq mjafton

1 PY. Së pari, Gjeneral, a jeni ju personi që i bën këto
2 komente këtu në ekran?

3 PË. Po.

4 PY. A pajtoheni me mua se ky është një shembull i asaj që ne
5 biseduam pak më herët, domethënë, zmadhimi, ekzagjerimi i
6 deklaratave publike për zmadhimin e rolit të UÇK-së?

7 PË. Po. Po nga ana tjetër edhe besoj që më shumë njerëz janë
8 bërë pjesë e UÇK-së gjatë luftimeve dhe besoj që ata kanë bërë
9 më të mirën e mundshme në mënyrë që kontrolli dhe komanda të
10 bëhej sa më funksionale brenda UÇK-së. Por thjesht nuk ia
11 dolën me aq sukses, të paktën jo me aq sukses sipas
12 standardeve tona.

13 Pra, me fjalë të tjera, unë mendoj që UÇK-ja mund të ketë
14 ditur kur bëhej fjalë për sulme serbe mizore ndaj popullatës,
15 por sa i takon raportimit në NATO ose sa i takon veprimit të
16 koordinuar, jo, nuk ekzistonte një UÇK kaq e strukturuar.

17 PY. Atëherë vlerësimi ose ndjesia që kjo ishte një organizatë
18 funksionale nuk ishte një vlerësim që kishte të bënte me
19 kapacitetet ushtarake të UÇK-së, apo jo?

20 PË. Jo.

21 PË. Jo, jo. Kjo ishte thjesht dëshira ime po nuk mbështetej
22 në kapacitetin ushtarak të UÇK-së.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Dua t'ju bëj një pyetje lidhur me
24 paragrafin e fundit në deklaratën që i keni dhënë Mbrojtjes që
25 është dokumenti 1D430, është paragrafi 19, dokumenti është

1 12550. Ju kujtohet ndjesë është paragrafi 18.

2 PY. Është e vërtetë apo jo, që ju u dërguat që të takonit
3 Milosheviqin pas Masakrës së Reçakut, kështu, Gjeneral?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. Në atë kohë komuniteti ndërkombëtar dëshironte që TPNJ-ja
6 të lejohej që të hetonte. Milosheviqi donte që këtë gjë ta
7 bënin njerëzit e tij, apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Përpara drekës ju folët lidhur me dezinformomini serb pas
10 konfliktit dhe mendoj që për një çast ju u referuat stisjeve
11 ose mosraportimit të duhur të numrit të popullatës që
12 ekzistonte pas konfliktit?

13 PË. Po.

14 PY. Po a është edhe çështje dizinformate serbe që ka ndodhur
15 gjatë konfliktit të 1998 dhe 1999, është përdorur
16 dizinformacioni dhe gjatë kësaj periudhe, Dëshmitar?

17 PË. Padyshim që është përdorur.

18 PY. Arsyeja që komuniteti ndërkombëtar nuk dëshironte që
19 njerëzit e Milosheviqit të bënin hetime në Reçak, pra, në
20 incidentin e Reçakut, kjo ka ndodhur për shkak të faktit që
21 ekzistonte rreziku që ai mund të ndryshonte, tjetërsonte
22 provat dhe do e bënte situatën të ngjashme me një situatë ku
23 konflikti dhe rasti i Reçakut ishte shkaktuar nga UÇK-ja?

24 PË. Dëgjo, kur Milosheviqi -- më kujtohet kur kemi pyetur
25 përpara një tribunali kriminal ndërkombëtar ai ka thënë, "Jo,

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 87

1 ne ...". Edhe ka thënë gjithashtu që "Ai po i kryente këto
2 hetime vetë". Dhe po ashtu, ideja kryesore ishte që ne nuk
3 donim që Milosheviqi të mos dezinformonte më siç kishte bërë
4 më herë dhe që do të mundohej që të manipulonte situatën.
5 PY. Nuk kam pyetje të tjera për ju, Gjeneral.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Do të bëjmë një pushim prej dhjetë minutash, pastaj do
8 vazhdojmë përsëri.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 --- Seanca ndërpritet në orën 15.29

11 --- Seanca rifillon në orën 15.42

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
13 sillni dëshmitarin në sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Gjenerali Clark, tani di të vijojmë me marrjen në pyetje nga
17 z. Halling që përfaqëson zyrën e Prokurorisë së Specializuar.
18 Pyetjet të palës tjetër nga z. Halling:

19 Z. HALLING: [Përkthim]

20 PY. Mirëdita, Gjenerali Clark. Jemi takuar më parë. Unë jam
21 Matt Halling nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. A më
22 dëgjoni mirë?

23 PË. Po ju dëgjoj shumë mirë.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Materiali i parë që do t'ju
25 tregoj, Gjeneral, është me numrin ERN, është një video 129433-

1 19 dhe nga minuta 07:52 deri në 08:58 dhe pastaj në gjysmën
2 tjetër njëkohësisht në gjysmën tjetër, në pjesën tjetër të
3 ekranit do shfaqim transkriptin që është 129433-19-TR-ET,
4 faqja 3.

5 PY. Dua të fillojmë me mënyrën se si e keni kuptuar atë që
6 keni ditur për UÇK-në. Më herët folët sot për sulmin ndaj Adem
7 Jasharit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është në faqen 15, 16 të
9 transkriptit të sotëm.

10 PY. Keni dhënë një intervistë në korrik të vitit 2022. Dhe
11 kjo është pjesa që duhet të shohim tani.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Pra, duke patur këtë parasysh po i
13 kërkoj Sekretarit të Gjykatës që të lëshojë videon.

14 [Luhet videoincizimi]

15 "... dhe ata kanë bërë gjëra të vogla si prita, vranë dy,
16 tre policë. Por serbët pastaj i kanë shtypur këto në mënyrë
17 brutale. Në shkurt të 1998-s, ata sulmuan atë që e quanin
18 udhëheqësin e grupit, Adem Jasharin, i cili kishte familje të
19 gjerë, kishte prona. Pra, ata u rrethuan nga policia serbe.
20 Dhe policia bëri dy nivele rrethimi rreth fermës së tij apo
21 shtëpisë së tij. I rrethuan dhe pastaj kur hynë brenda i ulën
22 njerëzit në dysHEME dhe i qëlluan ata, gra, fëmijë, bebe. Pra,
23 ky ka qenë incident eksploziv, shpërthyes dhe ka shkaktuar
24 fillimin e asaj që më vonë u bë, veprimet në Kosovë dhe
25 ndërhyrja e NATO-s. Kjo shtoi dhe rekrutimin për ushtrinë

1 çlirimtare të Kosovës. Dhe Shqipëria që nuk ishte e përfshirë
2 drejtpërdrejt" --

3 PY. Pra, Gjeneral, në pjesën e videos që pamë ju përshkruanit
4 të njëjtin incident të familjes Jashari që përmendët në
5 dëshminë tuaj dhe kjo ka ndodh në pjesën e parë të 1998-s?

6 PË. E saktë.

7 PY. Tani kur thoni aty që UÇK-ja bënte gjëra të vogla, si u
8 zinte pritë policëve dhe kështu me radhë, ju po flisnit për
9 atë që bënte UÇK-ja përpara shkurtit 1998?

10 PË. Po. Nuk jam i sigurtë për këtë, nuk e di a ka qenë kjo
11 përpara apo prapa. Por e di që ka qenë përpara hyrjes tonë
12 atje në Kosovë në verë të 1999-s -- pranverë të 1999-s. Por
13 nuk më kujtohen incidentet konkrete apo datat konkrete.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Tani, duke pasur këtë parasysh do
15 kërkoja të shfaqim në ekran Komunikatën 36, që është prova
16 materiale P279. Dhe versionin në anglisht dhe shqip.

17 PY. Dëshmitar, më herët thatë sot se nuk ju kujtohet të keni
18 parë ndonjë dokument të UÇK-së?

19 PË. E saktë.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po pres të shfaqet në ekran
21 versioni në anglisht.

22 PY. Pra, nga ajo që thatë më herët sot, me sa kuptoj, nuk
23 keni parë ndonjë komunikatë apo deklaratë të UÇK-së si kjo që
24 shihni këtu?

25 PË. Saktë.

1 PY. Këtu në fillim flitet për datën 11 dhe 12 shtator 1997:

2 "... përmes vendimit të Shtabit të Përgjithshëm, Shtabit
3 Qendror, njësitet e armatosura të UÇK-së kryen një aksion të
4 sinkronizuar në tërë hapësirën e zonës operative. Aksionet u
5 kryen në zonat e Drenicës, Erenikut, Pashtrikut, Dukagjinit"
6 dhe pastaj renditen, pra, këtu renditen 12 vende ku janë bërë
7 këto sulme.

8 Ky sulm i sinkronizuar në 12 komisariate apo stacione të
9 policisë, për këtë po flisnit ju kur përmendët pritrat që janë
10 bërë ndaj policëve, atë që përmendët në intervistën tuaj?

11 PË. Mund të jetë. Por, informacionet që kemi marrë mund të
12 jenë ndryshe për informacione që komunikohen këtu në këtë
13 rast. Nuk më kujtohen të kem parë një gjë të tillë -- ta
14 shohim pak. Unë duke parë këtë përshkrim këtu, besoj se jam
15 bërë komandant i NATO-s vetëm dy muaj më parë. Nuk më kujtohet
16 të kem parë diçka të tillë ku flitet për operacione të
17 sinkronizuara të UÇK-së, të paktën nga ajo që dinim ne në
18 nivel të NATO-s.

19 PY. Me sa e kuptoj unë përgjigjen tuaj nuk e dini nëse kjo
20 pritë është bërë duke u përdorur granatahedhës?

21 PË. Nuk e di nëse ka qenë pritë e sinkronizuar apo jo. Mund
22 të jetë raportuar si incident apo diçka e tillë. Ndoshta kanë
23 patur edhe granatahedhës. Po ta kishim ditur, do të ishte
24 raportuar, por nuk më kujtohet të kem parë ndonjë njoftim apo
25 informacion lidhur me këtë.

1 PY. Ju thatë që ndoshta ishin edhe granatahedhës, por e
2 kuptoj që ju nuk e dini kush mund t'i ketë siguruar këto armë,
3 apo jo?

4 PË. Nuk jam i sigurtë që e kuptoj pyetjen. Nuk e kam lexuar
5 të gjithë dokumentin në tërësi, nuk e lexova, por në qoftë se
6 ashtu shkruhet aty dhe ju thoni që ata kanë sulmuar me
7 granatahedhës, atëherë mund të kenë marrë granatahedhës nga
8 dikush tjetër dhe ndoshta mund t'i kenë ardhur dhe nga vetë
9 serbët.

10 PY. Duke e lënë mënjanë komunikatën, a keni dëgjuar
11 ndonjëherë për Shtabin e Përgjithshëm apo Shtabin Qendror të
12 UÇK-së i cili ka marrë përsipër veprime të tjera apo të tilla
13 si ky?

14 PË. Jo, s'kam dëgjuar.

15 PY. Në rregull.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë do kërkoja që të pranohet
17 pjesa e videos që pamë, pra, që është 129433-19, nga 07:52 në
18 08:58 sekonda. Dhe për transkriptin është faqja e parë që
19 shohim e intervistës dhe pastaj faqja e tretë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 129433-19,
23 ora 07:52-08:58 pranohet. Gjithashtu 129433-19-TR-ET faqja 3
24 pranohet.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe faqja 1 gjithashtu i nderuar

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 92

1 Gjykatës, që të shohim se kush është intervista, me kë bëhet
2 intervista.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Faqja 1 dhe 3.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
6 Pranohen.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Këto marrin numrin e
8 provës materiale P04512. Aktualisht janë të klasifikuara si
9 konfidenciale.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të bëhen publike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
12 Riklasifikohen si publike.

13 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoj Sekretarit të
15 Gjykatës të nxjerrë në ekran materialin SPOE00406173 deri në
16 00406230.

17 PY. Gjeneral, desha t'ju pyes a e njihni librin e shkruar nga
18 një person që quhet Henry Perritt dhe mban titullin "Ushtria
19 Çlirimtare e Kosovës: Historia nga brenda e një
20 kryengritjeje"?

21 PË. Nuk e kam lexuar librin.

22 PY. Mbrojtja e Thaçi na ka njoftuar neve për synimin e tyre,
23 që kishin synim t'jua tregonin këtë libër dhe ka dy gjëra në
24 këtë libër për të cilat dua t'ju pyes. Po pres që të shfaqet
25 në ekran.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faqja e parë kur të jetë gati.

2 Nëse mund të kalojmë tani në SPOE00406177 dhe fillojmë me
3 personat kush ka marrë pjesë në përgatitjen e librit që ta
4 njihni edhe ju.

5 PY. Pra, mund të shohim në paragrafin e dytë të faqes nëse
6 shkojmë më poshtë, nga mesi:

7 "Shumë shpejt Hashim Thaçi dhe komandant Remi gjithashtu
8 u shfaqën në -- shprehën inkurajimin dhe mbështetjen me
9 entuziazëm dhe ne po ishim duke ikur."

10 Ai shpjegon se si e ka bërë librin, si e ka përpiluar dhe
11 përgatitur librin.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe në qoftë se shkojmë në faqen
13 tjetër.

14 PY. Mund të shohim në anën e majtë ku personat të cilët kanë
15 punuar në këtë kapitull draft-kapitull. Edhe përmendet emri i
16 Hashim Thaçit aty. Dhe nuk do t'ju lexoj emrat e tjerë, po ka
17 shumë njerëz këtu që supozohet të kenë dhënë informacion në
18 libër të cilët janë aktualisht dhe kanë qenë ish-pjesëtarë
19 anëtarë të ekipit të mbrojtjes në këtë çështje. Por faqja për
20 të cilën desha t'ju pyes --

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar --

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Është interesante që --

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtimi im ka të bëjë me
24 komentin shtesë që u bë. Është hera e dytë që z. Halling u
25 përpoq të fusë një koment që është -- të bëjë një koment që

1 është i panevojshëm dhe e kundërshtoj.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Ne thjesht po përpiqemi të
3 orientojmë Gjeneralin sa i takon këtij libri dhe prejardhjes,
4 origjinës së këtij libri.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
6 rrëzohet, por kini kujdes.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Tani do kërkoj të kalojmë në
8 faqen SPOE002406218.

9 PY. Dhe në qoftë se shkojmë në fund të faqes, faqja 62 në
10 anën e majtë, aty thuhet: "Qëllimet strategjike të UÇK-së --
11 Qëllimet dhe objektivat strategjike të UÇK-së". Dhe z. Perritt
12 thotë -- do përqendrohem tani tek dy objektivat që më
13 interesojnë. Objektivi numër 3, qëllimi i UÇK-së është:

14 "Eliminimi i pjesëtarëve kyç të policisë, ushtrisë dhe
15 aparatit të sigurisë serbe, përfshirë bashkëpunëtorët,
16 kolaboratorët shqiptarë dhe spiunët."

17 Dhe pastaj shkojmë në krye të faqes në anën e djathtë,
18 numri 7:

19 "Të ndërtojmë simpati ndërkombëtare duke futur në
20 diskursin gjeopolitik idetë se forcat serbe në Kosovë
21 përfaqësojnë një forcë okupatore të huaj dhe në mënyrë të
22 vazhdueshme kanë shkelur të drejtat e njeriut, rezistenca
23 është ndërtuar dhe nuk mund -- është krijuar, forcuar dhe nuk
24 mund të zhduket dhe se luftëtarët e UÇK-së nuk janë
25 terroristë."

1 Pastaj autori shton:

2 "UÇK-ja nuk paraqiti një përputhshmëri të brendshme kaq
3 të saktë në ndjekjen e objektivave të saj ashtu siç e bëri
4 Milosheviqi ... Problemi kryesor strategjik për UÇK-në ishte
5 menaxhimi i konfliktit mes objektivit të tretë dhe të shtatë.
6 Në fund arriti ta bënte këtë me shumë aftësi dhe shkathtësi
7 edhe pse ndjekja penale pas luftë së udhëheqësve të UÇK-së ...
8 rihap çështjen e faktit nëse UÇK-ja në mënyrë legjitime ka
9 ndjekur objektivin e tretë."

10 Gjeneral, a ishit në dijeni të këtyre qëllimeve të UÇK-
11 së?

12 PË. Nuk kam qenë në dijeni të këtyre qëllimeve konkrete, por
13 ato kanë kuptim. Dhe unë nuk kam menduar asnjëherë se UÇK-ja
14 nuk kishte strategji apo nuk kishte synime. Është një prej
15 gjërave që me të cilën duhet të merresh në situata të tilla.
16 Por kur i shoh në peshore në të gjitha provat që më janë
17 dhënë, vënë në dispozicion mua, ajo që ka ndodhur në terren
18 dhe pasojat që ka patur në Bosnje, për Bosnjën, për misionin
19 ushtarak, misionin e stabilizimit në Bosnjë si dhe marrjen
20 parasysh të të drejtave të njeriut, pra, të situatës së të
21 drejtave të njeriut në Kosovë, më duket se kjo balancë ishte
22 shumë e qartë.

23 PY. Dua të kaloj në një faqe tjetër të këtij libri që të
24 shohim se si krahasohet kjo me provat që keni marrë ju,
25 dëshmitë që keni marrë ju.

1 Z. HALLING: [Përkthim] SPOE00406188.

2 PY. Dhe mund të vihet në anën e djathtë të ekranit ku
3 paragrafi lexon:

4 "Thaçi shpesh ishte ura e lidhjes midis planifikuesve në
5 ekzil me të gjithë të tjerët që ishin rreth tavolinës në
6 uniformë ushtarake. Por ai ishte gjithashtu edhe luftëtar. Ai
7 qëndroi në shtëpi të Jasharit në vitin 1992 për dy muaj pasi
8 serbët erdhën ta arrestojnë atë. Ai dhe Jashari mbanin një
9 pushkë dhe kanë bërë fotografi së bashku. Më vonë, ai kishte
10 prani të vazhdueshme në fushëbetejë dhe shpesh ka marrë pjesë
11 në konflikte të armatosura dhe për rrjedhojë ka fituar
12 respektin e të dy kampeve të UÇK-së."

13 Ky informacion a u erdhi juve, a kishe ti dijeni për
14 këtë?

15 PË. Jo në mënyrën se si është paraqitur saktësisht në këtë
16 libër, por gjithmonë kam patur përshtypjen, po, ka patur
17 njerëz jashtë Kosovës të cilët donin të çliroheshin nga
18 shtypja serbe dhe Thaçi ishte person që erdhi në Kosovë, hyri
19 dhe doli nga Zvicra dhe vendet e tjera dhe ne kemi menduar që
20 ai është kontakti. Tani, hollësitë se si ka funksionuar kjo
21 nuk i kam. Por nuk shoh ndonjë gjë në këtë. Dua të them që nuk
22 më duket çudi, nuk më habit kjo.

23 E kam fjalën, ne as nuk kemi menduar asnjëherë se
24 njerëzit, populli i Kosovës nuk kishte lidhje me jashtë, nuk
25 kishin një mendim përtej strategjisë, që ata ishin thjesht

1 njerëz që ishin bujq të nivelit të mesëm të cilët herë pas
2 here qëllonin ndaj një polici. Gjithmonë e kemi ditur se
3 kishte diçka më shumë prapa kësaj.

4 Por, në qoftë se mund të jap dhe një mendim lidhur me
5 këtë. E kam fjalën, gjatë Revolucionit Amerikan kishte fjalime
6 shumë të ashpra dhe strategji dhe kështu me radhë që bëheshin
7 nga Kongresi Kontinental dhe megjithatë nuk dukej se ata
8 kishin një komandë dhe kontroll efektiv, për një kohë të gjatë
9 nuk e patën atë. Pra, fakti që ishte dikush që shkruante gjëra
10 të tilla si kjo që pamë këtu dhe mund të mendojë gjërat në
11 mënyrë të logjikshme nuk do të thotë detyrimisht se ata kishin
12 një kontroll dhe komandë të efektshme apo efektiv dhe mendoj
13 që kjo është pika për të cilën ju po më pyesni që dhe unë të
14 komentoj.

15 PY. Kjo nuk ishte pyetja ime. Pyetja ime ishte nëse ju e
16 kishit këtë informacion më parë.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë në SPOE00406215.

18 PY. Kjo është pjesa e fotografisë së Hashim Thaçit dhe Adem
19 Jasharit. Dhe në pjesën e poshtme të djathtë mund të shihni
20 fotografinë --

21 PË. Nuk e kam.

22 PY. -- dhe shihni Hashim Thaçi mban në krah Adem Krasniqin?

23 PË. Jo, nuk e kam.

24 PY. Në fakt ju nuk e di nëse Hashim Thaçi ka luftuar apo jo.

25 Ju dini vetëm që ai ka qenë udhëheqës politik, a është kështu?

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 98

1 PË. Kjo është e saktë.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do doja që të
3 pranohen faqet e librit që u përdorën me dëshmitarin. Dhe këto
4 do të jenë faqen SPOE0040673 deri në 00406230, faqet ku
5 personat që kanë marrë pjesë në libër pranojnë pjesëmarrjen e
6 tyre që janë SPOE00406177 deri në 178 dhe faqet 188, 215, 218
7 janë tre numrat e fundit të secilës ERN.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
9 kundërshtim?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra,
12 SPOE00406173 deri në 00406230, faqet 177, 178 dhe 188, 215 dhe
13 218 pranohen.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Këto
15 gjashtë numra pranohen dhe marrin numrin e provës materiale
16 P0413. Aktualisht janë të klasifikuara publike.

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Gjeneral, më herët sot folët për mënyrën sesi ju keni
19 mbete keni qenë aktivisht i përfshirë në vitin 1998 në atë që
20 ndodhte në situatën në Kosovë, a është e saktë?

21 Lëvizët, pohuat me kokë por procesverbal duhet që të
22 shënohet.

23 PË. Po e kam bërë.

24 PY. A keni patur dijeni për sulmet e bërë nga UÇK-ja kundër
25 civilëve në verë të vitit 1998?

1 PË. Mund të kem dëgjuar. Nuk kam ndonjë kujtesë konkrete të
2 ndonjë incidenti por më duket si diçka që e kam dëgjuar.

3 PY. Nëse ju jap disa incidente që të shohim nëse ju freskon
4 kujtesën. A keni dëgjuar për pretendime se UÇK-ja ka kidnapuar
5 dhe vrarë minatorë serbë në Bardhi i Madh që njëhej dhe si
6 Bllasovaç në mes të vitit 1998?

7 PË. Nuk kam dëgjuar këtë gjë.

8 PY. A keni dijeni për kidnapimin nga ana e UÇK-së dhe vrasjen
9 e civilëve serbë në korrik të vitit 1998 që lidheshin me
10 ofensivën në Rahovec që njihet dhe si Orahovac?

11 PË. Nuk kam dëgjuar për këtë.

12 PY. Do të përpiqem dhe me një incident tjetër. A ishit në
13 dijeni se UÇK-ja ka mbajtur të ndaluar një delegacion politik
14 në Qirez në dhjetor të 1998-s?

15 PË. Nuk kam dëgjuar për këtë.

16 PY. Kur thatë se nuk ju kujtohet që të keni parë ndonjë
17 dokument të UÇK-së, a e kam të saktë se kjo do të thotë që nuk
18 keni patur dijeni, nuk kishit dijeni për përmbajtjen e
19 rregullave të UÇK-së?

20 PË. Është e saktë.

21 PY. E njëjta gjë vlen edhe për urdhrat apo raportet apo
22 procesverbalet apo informacionet që mund të vinin që kishin të
23 bënin me mbledhjet dhe takimet e UÇK-së?

24 PË. E saktë.

25 PY. A mund të identifikoni komandantët e Shtabit të

1 Përgjithshëm të UÇK-së apo zëvendëskomandantët?

2 PË. Në atë kohë, kjo ishte në vazhdim. Pra, unë u takova

3 herën e parë, kur u takova herën e parë me UÇK-në -- le të

4 kthehem pak më mbrapa. Unë kisha zëvendësin rus si komandant

5 të NATO-s dhe ndërkohë që veprimet në terren po shtoheshin në

6 vjeshtë të vitit 1998, ne ishim të shqetësuar për nxjerrjen e

7 urdhrit të aktivizimit dhe kështu me radhë. Ai më paraqiti dhe

8 më prezantoi pikëpamjen e rusëve. Dhe tha "UÇK-ja në të

9 vërtetë nuk ekziston". Ai tha, "Këta njerëz janë të gjithë

10 terroristë çeçen". Dhe unë i thashë atij, "A mund të më japësh

11 ndonjë dëshmi apo provë për këtë? Me gjithë qejf do ta shoh

12 atë". Pastaj pas nja dy, rreth dy javësh apo dy, tre javë më

13 vonë, ai solli një libër që pretendonte, ku pretendoj të

14 tregojë se UÇK-ja ishte e mbushur me çeçenë. Unë e pashë atë

15 dhe thashë që "Kjo nuk përputhet me asgjë që kam lexuar". Ai

16 buzëqeshi si me ironi dhe më tha që e dinte se ishte

17 dizinformacion i plotë nga shërbimet e inteligjencës apo të

18 zbulimit rus. Tani, ndoshta e kam gabim. Ndoshta ka marrë

19 informacionin se aty kishte çeçenë por nuk kam dëgjuar nga

20 asnjë burim tjetër këtë gjë përveçse nga rusët.

21 Pra, ka patur përpjekje aktive nga shumë anë e shumë palë

22 për të parë kush ishin këta njerëz, për të zbuluar kush ishin

23 këta njerëz dhe çfarë bënin. Hera e parë që i kam takuar ata,

24 hera e parë që janë përmendur emrat apo ndonjë gjë është kur

25 kam takuar delegacionin gjatë bisedimeve në Rambuje. Po edhe

1 aty, tetë prej tyre. Por në pozitat e tyre dhe kështu me
2 radhë, por këto nuk kishin ndonjë kuptim apo domethënie për
3 mua.

4 PY. Cilët ishin emrat e komandantëve të UÇK-së me të cilët ju
5 u takuat në bisedimet në Rambuje?

6 PË. Nuk e di cilët ishin komandantët e zonave, nëse ishin
7 komandantë zonash, nuk më kujtohet kush ishin aty. Ndoshta
8 Ramush Haradinaj ka qenë. Nuk më kujtohet.

9 PY. A i dini emrat e komandantëve të zonave operative, emrat
10 që ata ju dhanë atyre?

11 PË. Jo.

12 PY. Dhe ju përmendët Ramush Haradinaj. A e dini në cilën
13 pjesë të Kosovës ishte komandant ai apo si ishte emëruar?

14 PË. Nuk e di.

15 PY. Në rregull.

16 PË. Po dhe këtu po lexoj, nuk e kam lexuar librin dhe ndoshta
17 dikush në agjencinë tonë të inteligjencës mblidhte këtë
18 informacion, ndoshta kishte mungesë inteligjence por unë nuk
19 kam parë asgjë prej tyre.

20 PY. Pra, a jam i saktë se takimi i parë ku ju morët vesh se
21 po flisnit me komandantët e zonave ishte takimi që u bë pak
22 përpara periudhës së demilitarizimit që është në shtator të
23 1999, a është kështu?

24 PË. Nuk e di. Nuk jam i sigurtë kush ka qenë aty. Mendoj që
25 bëhet fjalë për takimin e 4 gushtit dhe mund të kenë qenë

1 komandantë në këtë takim gjithashtu.

2 PY. Në rregull. Por në këtë takim ju folët për takimin me
3 Hashim Thaçin dhe Agim Çekun. Nuk ju kujtohet të jeni takuar
4 me komandantë të zonave përpara këtij takimi, ju përshkruani
5 më herët në dëshminë tuaj takimin, përshkruat demilitarizimin
6 kur ju bënë pyetje nga Mbrojtja e Thaçit.

7 PË. Jo, nuk më kujtohet, sepse kur shkon në takime të tilla
8 dhe ka njerëz që janë ulur në tavolinë shpesh nuk i njeh të
9 gjithë personat që janë aty. Dhe në qoftë se dikush, vetëm në
10 qoftë se dikush i ka shkruar emrat ju nuk ju kujtohen emrat.

11 PY. E kuptoj. Por po përpigem të shoh nëse ju freskon diçka
12 kujtesën. A keni dëgjuar për një emër si Azem Syla?

13 PË. Jo.

14 PY. Sokol Bashota?

15 PË. Jo.

16 PY. Tani përmendët në seancën përgatitore se nuk dinit shumë
17 për Kadri Veselin, Rexhep Selimin apo Jakup Krasniqin.

18 PË. Jo, po i kam parë emrat e tyre përpara.

19 PY. A e dinit cilat kanë qenë përgjegjësitë e tyre gjatë
20 luftës?

21 PË. Jo.

22 PY. Tani do të flas pak për mënyrën sesi NATO ka funksionuar
23 në atë kohë që ju përshkruat në deklaratën tuaj. Por përpara
24 se të shkojmë aty, të flasim për vetë deklaratën tuaj. A jeni
25 në gjendje të na thoni përafërsisht sa herë jeni takuar me

1 Mbrojtjen e Thaçit për të marrë këtë për dhënien e deklaratës
2 e cila ju tregua disa herë sot?

3 PË. Ndoshta tre herë.

4 PY. A jeni informuar ndonjëherë se për çfarë krimesh akuzohen
5 ata në këtë çështje?

6 PË. Jo, konkretisht.

7 PY. Mendoj që iu përgjigjët pyetjes time në vijim.

8 Tani të flasim për NATO-n, folët për shkallën e
9 informacioneve që merrnit si dhe në deklaratën tuaj tregoni që
10 keni marrë informacione nga persona me përvojë në terren
11 përfshirë informacionet që vinin prej zbulimit? Ju pohuat me
12 kokë po duhet për transkript ta thoni me zë.

13 PË. Po, po.

14 PY. Ky informacion që keni marrë prej inteligjencës, prej
15 zbulimit gjatë fushatës ajrore a ndodhet të ishte ndonjëherë
16 të ishte informacion i gabuar?

17 PË. Është e vështirë të thuhet kjo gjë. Dhe mund të ketë
18 pasur gabime. Informacionet për shtabin ishin të gabuara, po
19 ne e verifikuam. Ne fluturuam për dy ditë përpara se ta
20 godisnim selinë. Po nuk janë gjithmonë informacionet të saktë
21 jo.

22 PY. Kur thoni që informacioni për selinë ishte gabim, a mund
23 të na tregoni diçka më shumë në lidhje me këtë ngjarje?

24 PË. Po. Më vonë u kuptua që ishte një pikë grumbullimi që e
25 administronte ushtria serbe, ose mbase MUP-i, ku vendosnin

1 civilë shqiptarë brenda një ndërtese dhe ishte e rrethuar
2 ndërtesa me automjete serbe dhe kishte transmetim me radio nga
3 godina dhe anasjelltas. Dhe na thanë që kjo është një seli e
4 institucioneve serbe. Kështu që ne e caktuam këtë si
5 shënjestër dhe besoj se vramë 80 civilë të pafajshëm.

6 PY. Pra, ju mendeni që kjo ishte për shkak të informacionit
7 të gabuar që morët?

8 PË. Po. Absolutisht po.

9 PY. Në cilësinë tuaj si SACEUR, edhe biseduam për këtë sot,
10 ju thatë që kishit pasur përgjegjësi për kontrollin strategjik
11 të forcave të NATO-s?

12 PË. Po. Kisha kontroll strategjik në kuadër të situatave,
13 pra, në kontekst të komandës dhe kontrollit ushtarak ka dhe
14 mosmarrëveshje apo jo?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe sigurisht që ju thatë më përpara që "në luftëra ka
17 dhe mosmarrëveshje të mëdha. Qëllimi është fitorja."

18 PË. Po.

19 PY. Këto mos pajtime ndonjëherë vijnë për shkak të vartësve
20 që nuk duan t'u binden urdhrave, apo jo?

21 PË. Ka dhe raste të tilla, po.

22 PY. Më herët sot në faqen 34 të transkriptit të ditës së
23 sotme, ju folët për fushën ajrore të Prishtinës. Do t'ju bëj
24 disa pyetje për këtë.

25 Gjeneral Mike Jackson, si komandant i KFOR-it, ka qenë

1 një prej vartësve tuaj?

2 PË. Në fakt nuk ka qenë vartës i drejtpërdrejtë. Ellis,

3 Admirali Jim Ellis ishte vartësi i im. Ai ishte vartës i

4 Admiralit Jim Ellis.

5 PY. Po në kuadër të zinxhirit hierarkik, ju ishit personi që

6 mund të jepnit urdhra drejtpërdrejt Gjeneralit Jackson?

7 PË. Jo, unë nuk mund t'i jepja urdhra Gjeneralit Jackson.

8 Mund t'i jepja urdhra Admiralit Jim Ellis.

9 PY. A është e vërtetë që ju i keni thënë ju Gjeneralit

10 Jackson për të bombarduar një pikë në Prishtinë?

11 PË. Nuk është e saktë.

12 PY. Na e sqaroni çfarë nuk është e saktë.

13 PË. Më 7 qershor, e martë, më mori një oficer francez dhe më

14 tha, "Ka një problem në fushën ajrore në Prishtinë". Unë e

15 pyetja "Çfarë?" Ai më tha, "Do të ndodhë diçka atje. Po nuk e

16 di çfarë do të ndodhë". Të nesërmen në telekonferencën me

17 video me Admiralin Ellis dhe Mike Jackson, e përmenda këtë

18 raportim që më erdhi, këtë informacion që më erdhi dhe e pyeta

19 Gjeneralin Jackson dhe i kërkova Gjeneralit Jackson që të

20 përgatitej për ndonjë situatë të caktuar, të kishte një plan

21 kontigjence, të ishte gati të kundërpërgjigjej dhe të më

22 thoshte çfarë plani kishte. Kjo ka qenë të mërkurën.

23 Të enjten, nuk më tha asnjë informacion, nuk ma treguan

24 planin që kishin përgatitur. Të premten, kur rusët tërhoqën

25 batalionin nga Bosnja dhe u nisën drejt Kosovës, Madeleine

1 Albright, Sekretarja e Shtetit, ishte atje dhe nuk po
2 kontaktonim dot me Admiralin Ellis. Ai ishte në fakt gjatë
3 gjithë kohës bashkë me znj. Albright. Mike i kisha dhënë një
4 paralajmërim dhe i kisha thënë të ishte i përgatitur, por unë
5 doja të dija çfarë plani kishte ai. Unë nuk e dija çfarë plani
6 kishte përgatitur ai. Më pas ai kaloj përmes kanaleve
7 britanike dhe i tha shefit të Mbrojtjes se mendonte se ishte
8 gabim ta ekzekutonte, ta vinte në jetë planin e tij. Po i mirë
9 a i keq, ky ishte një plan që unë s'e kisha parë. As nuk i
10 kisha thënë të ekzekutonte një plan sepse unë nuk e kisha parë
11 këtë plan me sytë e mi.

12 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës të
13 nxjerrë në ekran materialin DHT11103 deri në DHT11632 në faqen
14 DHT11538.

15 PY. Gjeneral, keni shkruar një libër për luftërat moderne,
16 apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Dua t'ju tregoj një faqe të librit ku keni treguar disa
19 nga komunikimet që keni pasur me Gjeneralin Jackson. Faqja në
20 fjalë -- presim nj çast që të shfaqet në ekran.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Pra dhe njëherë numri i faqes
22 është 11538. Po. Shkojmë pak më poshtë në faqe.

23 PY. Këtu keni përshkruar rrjedhën e ngjarjeve për incidentin
24 në fjalë.

25 ``SACEUR, a mund të bisedojmë pak tani në zyrën time?'

1 tha Jackson teksa po largoheshim nga mbledhja.

2 "Kur hymë brenda, patëm një diskutim të çiltër. Ndër
3 çështjet serioze që diskutuam, Jackson ishte i mërzhitur, ishte
4 i zemëruar. Ishte shumë i emocionuar. Unë mendova se do të
5 diskutonim çështjet praktike. Nuk e prita që të ishte kaq i
6 emocionuar apo kaq emotiv, po duhet ta kisha marrë parasysh."

7 Ai më tha:

8 "'Zotëri, nuk marr më urdhra nga Uashingtoni'.

9 "'Mike, nuk janë urdhra nga Uashingtoni, janë urdhra të
10 mitë."

11 Dhe ai më pyeti:

12 "'Në cilësinë e kujt?'

13 "'Në cilësinë time si SACEUR.'

14 "'Nuk e ke këtë autoritet.'

15 "'E kam këtë autoritet. Kam pas vetes Sekretaren e
16 Përgjithshme për këtë.'

17 "Zotëri, nuk do të filloj luftën e tretë botërore për ty
18 ...'"

19 PË. Nuk është thënë tamam kështu, duhet ta kuptojmë.

20 PY. Po janë fjalët tuaja. Si është thënë?

21 PË. Është ndonjë problem të shkruash libra dhe të fut në
22 telashe kjo gjë. Ky është një rresht shumë i famshëm që është
23 diskutuar shumë. Po nuk është thënë në tonin që e përdorët ju,
24 kur më tha, "Zotëri, nuk do të filloj luftën e tretë botërore
25 për ju". Jua premtoj unë. Është thënë në mënyrë më provokative

1 sesa kaq. Sikurse kam shpjeguar dhe këtu, unë u përpoqa ta
2 ulja tensionin. Unë doja të parandaloja një ballafaqim sepse
3 po merrnim raportime se rusët po përgatiteshin të sillnin
4 forcat e tyre në Prishtinë, në fushën ajrore të Prishtinës. Që
5 ta kuptoni tamam panoramën. Nuk dua t'ju ndërpres. Më mirë ma
6 bëni ju pyetjen. S'po ju jap informacion dhe unë do ju them
7 çfarë nuk keni kuptuar.

8 PY. Ju keni folur me dikë që është nën ju në hierarki dhe po
9 flisnit për një urdhër edhe ai nuk ishte i gatshëm të
10 respektonte urdhrin tuaj, nëse më lejoni të shprehem kështu?

11 PË. Jo, nuk është kështu. Në fakt, ai nuk e ekzekutoi
12 misionin të premtën. Por unë nuk i kisha dhënë urdhër ta
13 ekzekutonte.

14 Kjo ishte diçka tjetër. Ishte incident tjetër. Janë dy
15 gjëra të ndara. Mund t'ua shpjegoj?

16 PY. Po.

17 PË. Të premtën në mëngjes, 11 qershor, thirra Mike dhe
18 Sekretarin e Përgjithshëm kur mora vesh që ishin larguar rusët
19 dhe u thashë, "Nuk mund të çoni ca trupa aty në Prishtinë që
20 të mos të lejojmë të futen persona të tjerë?" Dhe më tha që,
21 "Do përpiqem". Thirra në telefon Pentagonin. Sekretarja e
22 Përgjithshme nuk ishte e disponueshme dhe vartësit e saj më
23 thanë që, "Pse nuk çoni një oficer atje për të parë çfarë do
24 të funksionojë, çfarë mund të bëni?" Dhe në këto momente u
25 përpoqa të kontaktoja Mike Jackson. Dhe ai më tha që ai kishte

1 një plan, "E kam një plan" më tha, po unë nuk e dija këtë
2 plan. Dhe pa e ditur unë çfarë ishte plani, të gjithë ishin në
3 gatishmëri në ato momente, shefi i mbrojtjes britanike kishte
4 folur me Sekretaren e Përgjithshme apo ministrin e mbrojtjes
5 britanik dhe kishin vendosur që t'i lejonin rusët të bënin
6 ç'të donin. Mos u përfshini me ta. Prandaj të premtën nuk
7 ndodhi asgjë.

8 Jackson më tha mos u shqetëso, do t'i çoj unë forcat atje
9 që të shtunën në mëngjes. Unë e pyeta, "Po kur do filloni?" Ai
10 më tha "Menjëherë".

11 Në orën 8.00 asgjë s'ndodhi. Ora 10.00 asgjë, në mesditë
12 pothuajse asgjë nuk po ndodhte. Dhe unë e pyeta Mike "Po çfarë
13 po ndodhë?" Ai më tha që nuk po i lëvizë dot forcat. Më në
14 fund ai shkoi në fushën ajrore. Mbase rreth orës 5.00, 6.00
15 pasdite. shkoi në fushën ajrore edhe më tha që është një BMP
16 ruse që po qarkullonte aty dhe vendosi të largohet nga fusha
17 ajrore dhe të mos ballafaqohet me rusët. Pra, nuk u bë asgjë.

18 Pra, udhëzimet që unë shpresova që ai do t'i respektonte
19 ishin që ai të shkonte në fushën ajrore dhe të vendosej atje.
20 Këtë nuk e bëri ai. Këtë nuk mund ta bënte ai.

21 Më pas më mori në telefon mua Uashingtoni dhe më thanë le
22 të çoje disa helikopterë, të vendosnit disa helikopterë
23 thjesht të bllokojë rusët atje, këtë informacion ia kalova
24 Admiralit Ellis. Admirali Ellis ia përcolli këtë Jackson.
25 Rreth orës 10.00 në darkë, Ellis më tha, "Jackson nuk pranon

1 të vendosë helikopterë atje dhe më tha se është shumë e
2 rrezikshme se ka stuhi dhe nuk mund të ulen helikopterët. Dhe
3 unë i thashë "Në rregull, Ellis, mos u shqetëso. Do të shkoj
4 vetë nesër paradite atje dhe do takohem me Jackson". Këtu
5 mbeti e gjithë biseda.

6 Më pas lindi pikëpyetja po çfarë do të bëjmë me bllokimin
7 e pistës dhe pikërisht kjo është biseda që kam diskutuar unë
8 në libër, pa pasur plan.

9 PY. I bllokuat pistat me helikopterë përfundimisht?

10 PË. Jo. Dua t'ju bëj diçka të qartë sidoqoftë: Si komandant
11 asnjëherë nuk do ta kisha urdhëruar Mike Jackson të bënte
12 diçka që ai mendonte se nuk mund ose nuk duhet ta bënte pa e
13 diskutuar tërësisht çështjen në fjalë dhe doja të kuptoja
14 çfarë kundërshtimesh kishte ai. Dhe para se të shkonin tek
15 masat konkrete, u bë ky diskutimi lidhur me personin
16 përgjegjës.

17 PY. Pavarësisht se ai kundërshtoi udhëzimet tuaja, ju prapë
18 mendonit se ai ishte personi i duhur për të udhëhequr KFOR-in?

19 PË. Patjetër, po.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të kem
21 shumë faqe që do të diskutoj në këtë libër "Të luftosh në
22 kohërat moderne", do të doja që të pranoheshin në fakt të
23 gjitha faqet që do diskutojmë me dëshmitarin. Në fillim do të
24 kërkoj që të pranoni vetëm faqen e parë, pra, që është faqja
25 11538.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
2 kundërshtime?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja
5 pranohet.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky material do të marrë
7 numrin e provës P04514 dhe klasifikimi është publik.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Gjeneral, për sot pothuajse mbaruam. Unë do të vijoj
10 nesër. Por shkurtimisht përpara se ta mbyllim ditën e sotme të
11 flasim për periudhën pas Marrëveshjes Teknike Ushtarake dhe
12 Marrëveshjen për Demilitarizimin e UÇK-së që u nënshkruan në
13 qershor 1999. Keni bërë komente të ndryshme në deklaratat
14 tuaja por dhe në dëshminë tuaj.

15 A mund të themi që Slobodan Milosheviqi nuk ishte një
16 person i besueshëm dhe nuk do ta respektonte fjalën, nuk do ta
17 mbante fjalën?

18 PË. Po dhe jo.

19 PY. Shpjegojeni, ju lutem.

20 PË. Milosheviqi, nëse do të detyrohej, në mënyrë
21 sipërfaqësore do t'i mbante premtimet, do t'i respektonte
22 premtimet. Por unë nuk isha i kënaqur sepse kishte synime për
23 të sabotuar misionin e NATO-s edhe mundësisht të rifitonte
24 kontrollin në pjesën më të madhe të Kosovës.

25 PY. Se marrëveshja e tetorit 1998 që e diskutoni në

1 deklaratën tuaj, është një marrëveshje të cilën ai nuk e
2 respekton?

3 PË. Nuk e nënshkroi. Ky është çelësi. Nëse nuk e nënshkruan,
4 siç ma tha në takimin e tretë me të, ai më tha "S'kam pse ta
5 nënshkruaj". I thashë, "Z. President, duhet ta nënshkruash".

6 PY. Dhe pas këtij komunikimi dhe pasi e nënshkroi, ai e
7 respektoi vetëm përkohësisht marrëveshjen, apo jo?

8 PË. Po. Unë mendoj se në këtë rast ka qenë një delegacion rus
9 në Beograd. Ka qenë dhjetor besoj. Unë nuk kam informacion të
10 përpunuar specifik për këtë, po ky është supozimi im, që
11 fushata e NATO-s është diskutuar me rusët dhe rusët në thelb i
12 kanë thënë, "Mos u shqetëso. S'kanë për ta bërë. Shko spastroi
13 këta njerëz si të dëshirosh", sepse të njëjtat forca që janë
14 tërhequr u rikthyen.

15 PY. Sot folët dhe për hetimin për Masakrën e Reçakut dhe ju
16 menduat se ai do ta cenonte këtë hetim, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Të flasim tani për Mitrovicën në verën e 1999-s. Ju bënë
19 pyetje për Mitrovicën, ju treguan një artikull në media. UÇK-
20 ja ka kërcënuar se do të ndërmernte masa ushtarake për t'u
21 kundërpërgjigjur asaj që serbët po bënë në Mitrovicë në verën
22 e 1999-s, apo jo?

23 PË. Nuk kam dijeni për këtë. Nuk më është raportuar si
24 kërcënim i UÇK-së kjo.

25 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, do të donim

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 113

1 t'i tregonim një dokument dëshmitarit. Po për shkak të
2 kufizimeve prej ofruesve të informacionit, do të duhet që të
3 kalojmë në seancë private.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Kalojmë në seancë private.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Duhet vetëm pak minuta.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Wesley Clark (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling

Faqe 114

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

18 Faleminderit.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Besoj se është

20 momenti për ta mbyllur për sot duke parë orën.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjeneral

22 Clark, për sot përfunduar. Keni pasur një ditë të gjatë, uroj

23 të pushoni pak sonte, do të shihemi nesër në orën 9.00.

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

1 që erdhët sot.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling,
4 sa kohë mendoni se do ju nevojitet.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Mendoj se do përfundoj në pjesën e
6 dytë nesër. Pra, pas pushimit të orës 11.00 por besoj se do të
7 përfundojmë para pushimit të drekës në orën 1.00.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 --- Seanca mbyllet në orën 16.29

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25